



Tirane , .03.2016

## ANALIZA VJETORE 2015


Mbi realizimin e treguesve kryesore tekniko- ekonomikë nga  
Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor  
për periudhën 12/mujore 2015.

### DREJTORIA EKONOMIKE

Për periudhën 12/mujore 2015 treguesit tekniko-ekonomikë të realizuar nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor, paraqiten si më poshtë:

Të ardhurat e DPSHTRr-së të realizuara gjatë Vitit 2015 janë në masën 1,721,732 mijë lekë nga 1,628,000 mijë lekë të planifikuara, pra realizimi është në masën 105% ose 93,732 mijë lekë më shumë se plani. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2014 ka një tejkalim në masën 58,293 mijë lekë ose 4% më shumë.

Realizimi i të ardhurave nga Drejtoritë Rajonale në mënyrë grafike, paraqiten si më poshtë:






Përbërja e të ardhurave sipas sektorëve të aktivitetit është:


|                         |     |                       |
|-------------------------|-----|-----------------------|
| ► Regjistrimi i mjeteve | 39% | ose 667.882 mije leke |
| ► Lejet e drejtimit     | 37% | ose 644.101 mije leke |
| ► Taksat                | 16% | ose 270.710 mije leke |
| ► Kontrolli rrugor      | 2%  | ose 33.358 mije leke  |
| ► Të tjera              | 6%  | ose 105.681 mije leke |

Struktura e të ardhurave sipas aktiviteteve per periudhen 12/mujore 2015



Realizimi i të ardhurave sipas sektorëve, krahasuar me programin ekonomik të kësaj periudhe, paraqitet në grafikun më poshtë:

Te ardhurat e realizuara sipas aktiviteteve per periudhën 12/mujore 2015



**Regjistrimi i Mjeteve**

Në Sektorin e Regjistrimit të Mjeteve për vitin 2015 janë realizuar 667,882 mijë lekë të ardhura në masën 92% ose 57,358 mijë lekë më pak kundrejt 725,240 mijë lekë të parashikuara në programin ekonomik, ndërsa në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2014 kemi tejkalim me 3% ose 23,649 mijë lekë më shumë. Nga sektori i tahogرافit kemi të planifikuara 31,240 mijë lekë dhe janë realizuar 8,431 mijë lekë ose 26.9%, i cili është dhe një ndër faktorët e mosrealizimit të të ardhurave në këtë sektor, realizimi i të ardhurave për regjistrimin e mjeteve pa tahografin del 95 %. Në sektorin e regjistrimit të mjeteve janë kryer 435.137 veprime, ose 11% më shumë se viti 2014.


**Lejet e Drejtimit**

Në Sektorin e Lejeve të Drejtimit janë realizuar 644,101 mijë lekë të ardhura, kundrejt 616,400 mijë lekë të parashikuara në Programin-Ekonomik. Janë realizuar në masën 104% ose 27,701 mijë lekë më shumë. Gjithashtu në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2014 kemi një rritje të të ardhurave me 12% ose 67,212 mijë lekë më shumë, kjo për shkak të rritjes së numrit të veprimeve nga 475,716 në vitin 2014 në 536,146 në vitin 2015, pra 13% më shumë.


Shërbimet në të cilat janë rritur më shumë veprimet janë:

| Sherbimet (copë)                          | Viti 2014 | Viti 2015 |
|-------------------------------------------|-----------|-----------|
| •Pajisje me autorizim per kursin(teorik)  | 61,525    | 66,691    |
| •Pajisje me autorizim per kursin(praktik) | 56,709    | 69,030    |
| •Provim i njohurive (teorike)             | 61,012    | 66,199    |
| •Provim i njohurive (praktike A, B B+E)   | 50,499    | 61,824    |
| •Dcmtim dhe rinovim i L.D                 | 49,566    | 54,574    |

Kalueshmëria e aplikanteve për pajisjen me lejë drejtimi sipas drejtorive rajonale paraqitet në dy grafikët e mëposhtëm si për testimin teorik ashtu dhe për testimin praktik. Niveli i kalueshmërisë në rang republike në testimin teorik është 64.5%, kalueshmërinë më të lartë e ka DR Peshkopi me 83.2% dhe DR Laç me 76%, ndërsa nivelin më të ulët të kalueshmërisë DR Korçë me 56 %, dhe DR Tirane me 59%.



Niveli i kalueshmerise në rang republike në testimin praktik është 84.1%, kalueshmerinë më të lartë e ka DR Durrës me 89.6%, DR Lac me 91.6%, ndërsa nivelin më të ulët të kalueshmerisë e ka DR Gjirokastrë me 73% dhe DR Fier 72%



#### Të ardhurat nga taksat.

1-Të ardhurat për buxhetin e shtetit të vitit 2015 janë parashikuar nga Ministria e Financave si të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura të transportit shuma 3,257,250 mijë lekë. Këto të ardhura mbledhen në rolin e agentit tatimor nga ana e DPSHTRR-së nëpërmjet Drejtorive Rajonale.

Për vitin 2015 nga ana jonë janë arkëtuar në buxhetin e shtetit 4.138.805 mijë lekë ose 127% e planit, kjo e ndare si me poshtë:

- Nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura është realizuar 3,862,786 mijë lekë, nga 3,257,250 mijë lekë të parashikuara në programin ekonomik, pra është realizuar në masën 118%.
  - tarifa e lejës së drejtimit është realizuar 276,019 mijë lekë.
- Nga shumat së derdhura në buxhetin e shtetit i është hequr 5% që mbahet nga ana jonë në zbatim të ligjit si agjentë i mledhjes se ketyre taksave si dhe 18% që u kalohet komunave dhe bashkive.



Pra siç shikohet kemi një performance shumë të mirë si institucione dhe një kontribute me tejkalim në të të ardhurat e realizuara në buxhetin e shtetit për vitin 2015.

2-Të ardhurat nga taksat për periudhën 12/mujore 2015 janë realizuar 270,710 mijë lekë, nga 221,160 mijë lekë që janë parashikuar në Programin-Ekonomik, pra ka një realizim në masën 122% ose 49,550 mijë lekë më shumë.

Të ardhurat e realizuara në krahasim me programin janë:

- tarifa e lejes së drejtimit është realizuar 14,484 mijë lekë, nga 10,950 mijë leke pra është realizuar në masën 132%,
- taksa vjetore e mjeteve të përdorura është realizuar 247,944 mijë, nga 203,310 mijë lekë të parashikuara në programin ekonomik, pra është realizuar në masën 122%. Kjo rritje e të ardhurave tregon punën e mirë në ndjekjen e debitoreve të taksave. Po kështu në planifikim nuk janë përfshirë gjërat e TVMP-se,
- e ardhura nga shërbimi i mjeteve me taksa të përjashtuara është realizuar 8,283 mijë lekë, nga 6,900 mijë lekë të parashikuara, në masën 120%.

Përbërja e të ardhurave nga taksat paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Perberja e te ardhurave nga taksa per perludhen 12/mujore 2015

Tarifa e lejes se  
drejtimit 14,484  
5%

Taksa te  
Perjashtuara  
8,283  
3%


Taksa e mjeteve te  
perdorura, 247,944  
92%

■ Taksa e mjeteve te perdorura  
■ Tarifa e lejes se drejtimit  
■ Taksa te Perjashtuara

Realizimi i të ardhurave nga taksat sipas llojit të tyre krahasuar me programin ekonomik paraqitet si më poshtë:



Të ardhurat nga taksat për perludhen 12/mujore 2015



Gjatë këtij viti janë arkëtuar 398.601 taksa të vitit aktual, nga këto të përfunduar nga ligji (invalidë, rimorkio etj) janë 31.849. Taksa të prapambetura janë arkëtuar 41.501 copë (nga këto të përfunduar 8,330 cope), gjithashtu janë arkëtuar 119,206 copë gjoba të TVMP-së.

### Kontrolli rrugor

Në Sektorin e Kontrollit Rrugor janë realizuar 33,358 mijë lekë të ardhura, kundrejt 31,500 mijë lekë të parashikuara në Programin-Ekonomik. Janë realizuar 106% ose në masën 1,858 mijë lekë më shumë, ndërsa krahasuar me vitin 2014 kemi një tejkalim në vlerën 9,003 mijë leke ose 37% më shumë. Ka rritje të numrit të veprimeve nga 10,755 në vitin 2014 në 11,560 veprime në vitin 2015. Realizimi i të ardhurave sipas DR paraqitet si më poshtë:



Realizimi i te ardhurave nga kontrolli rrugor per periudhen 12/mujore 2015



Ndërsa të ardhurat në zërin “te tjera” në krahasim me programin janë me tejkalim në vlerën 71,981 mijë lekë. Ky rezultat është për efekt të rritjes së të ardhurave të realizuara pasi në planifikim nuk përfshihen *gjobat e kontrollit teknik vjetor dhe interesat*.

Gjatë vitit 2015 prane sporteleve të Drejtorive Rajonale janë kryer 1,590,588 veprime shërbimi ndaj qytetareve, në krahasim me vitin 2014 janë kryer 176,731 veprime me shume.

**Shpenzimet** të realizuara gjatë këtij viti janë 1,342,335 mijë lekë, nga 1,454,599 mijë lekë të parashikuara në Programin Ekonomik të vitit 2015. Janë realizuar rreth 112,264 mijë lekë më pak ose në nivelin 92.2%.

Në përgjithësi të gjithë zërat e shpenzimeve të programuara për periudhën në fjalë janë me kursim, me përjashtim të zërave

- “Shpërblime për vjetërsi në punë” ka arritur vlerën 8,967 mijë lekë
- Shpenzimi në zërin “Gjopa dëmshpërblime” ka arritur vlerën 11,737 mijë lekë
- Shpenzimi në zërin “Qera Objekti” ka arritur vlerën 1,381 mijë lekë
- Shpenzimi në zërin “Blerje mallra me vlerë” ka arritur vlerën 847 mijë lekë
- Shpenzimi në zërin “Blerje energji uje” ka arritur vlerën 230 mijë lekë

Shpenzimet për çdo drejtori rajonale paraqiten si më poshtë:

- ✓ **DR Berat** në zërin “blerje mallra me vlerë” në vlerën 22 mijë lekë për shkak të rritjes së numrit të qytetareve që kanë fituar provat dhe janë pajisur me leje drejtimi për të gjitha kategoritë,
- ✓ **DR Durrës** në zërin “blerje materiale” në vlerën 100 mijë lekë, në zërin “blerje energji, ujë” në vlerën 360 mijë lekë, në zërin “blerje kancelari” në vlerën 100 mijë lekë,
- ✓ **DR Elbasan** në zërin “blerje materiale” në vlerën 484 mijë lekë në zërin “blerje mallra me vlerë” në vlerën 1,573 mijë lekë e cila është në varesë të tejkalimit të ardhurave,
- ✓ **DR Fier** në zërin “shpenzime pritje dhurata” ka arritur vlerën 92 mijë lekë



- ✓ DR Gjirokastrë paraqitet me tejkallim në zërin "mirembajtje riparime" në vlerën 25 mijë lekë, në zërin "ruajtje objekti, shërbim nga të III" në vlerën 397 mijë lekë
- ✓ DR Korçë paraqitet me tejkallim në zërin "blerje mallra me vlere" në vlerën 676 mijë lekë,
- ✓ DR Kukës paraqitet me tejkallim në zërin "Blerje materiale" në vlerën 156 mijë lekë, në zërin "blerje energji uje" në vlerën 96 mijë lekë, në zërin "blerje mallra me vlere" në vlerën 15 mijë leke, në zërin "prime sigurime" në vlerën 20 mijë leke për shkak të shtimit të një mjeti, në zërin "ruajtje objekti shërbime nga të III" në vlerën 224 mijë leke si rezultat i shtesës së kontratës, në zërin "paga punonjësve" në vlerën 677 mijë leke si rezultat i punonjësve prizor, në zërin "shpërblime nga taksa" në vlerën 165 mijë leke, në zërin "shpenzime rrjedhese" në vlerën 24 mijë leke
- ✓ DR Laç paraqitet me tejkallim në zërin "Blerje energji uje" në vlerën 71 mijë lekë, në zërin "Shpenzime PTT" në vlerën 128 mijë lekë,
- ✓ DR Dibër paraqitet me tejkallim, në zërin "udhetime dieta" në vlerën 128 mijë lekë në zërin "Shpenzime PTT" në vlerën 22 mijë lekë, në zërin paga e punonjësve në vlerën 41 mijë leke.
- ✓ DR Shkodër paraqitet me tejkallim në zërin "qera objekti" në vlerën 1,794 mijë lekë, në zërin "shpenzime PTT" në vlerën 430 mijë lekë,
- ✓ DR Tiranë paraqitet me tejkallim në zërin "blerje energji uje" në vlerën 134 mijë lekë, në zërin "blerje mallra (me vlere)" në vlerën 2002 mijë lekë në varësi të tejkallimit të të ardhurave, në zërin "prime sigurime" në vlerën 246 mijë lekë, në zërin "udhetime dieta" në vlerën 32 mijë leke,
- ✓ DR Vlorë paraqitet me tejkallim në zërin "blerje materiale" në vlerën 146 mijë lekë, në zërin "blerje energji uje" në vlerën 15 mijë lekë, në zërin "shpenzime amortizimi" në vlerën 517 mijë leke për shkak të shtesës së amortizimit për investimin e bërë gjatë vitit 2015,
- ✓ DR Sarandë paraqitet me tejkallim në zërin "blerje materiale" në vlerën 59 mijë lekë, e cila ka ardhur nga furnizimet që kemi marrë në DTSH-Durrës, të cilat kanë qenë të domosdoshme për ecurinë e punës (dosje shoferi, dosje mjeti, etj), në zërin "blerje mallra (me vlere)" në vlerën 405 mijë lekë në varësi të tejkallimit të të ardhurave, në zërin "mirembajtje riparime" në vlerën 20 mijë leke, në zërin "Shpenzime rrjedhese (uniformat e kontrollit rrugor)" në vlerën 263 mijë leke.
- ✓ DTSH paraqitet me tejkallim në zërin "të tjera tatime taksa" në vlerën 30 mijë lekë si rezultat i pagesës së takave të mjetit në ruajtje.

Fitimi bruto i realizuar për vitin 2015 është 379,399 mijë lekë, nga 173,401 mijë lekë i parashikuar në program 118 % më shumë dhe krahasuar me vitin 2014 ka tejkallim 79,257 mijë leke ose 26 % më shumë. Ky rezultat është për efekt të rritjes së të ardhurave të realizuara dhe pakësim të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2015. Në planifikim nuk janë përfshirë gjërat e TVMP-së si dhe gjërat e kontrollit teknik vjetor.



### Investimet

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor kryen investimeve duke shfrytëzuar burimet e veta.

Fondi i zhvillimit pas situates se krijuar nga derdhja ne Buxhet e shumes prej 1.000.000.000 leke (ne vitin 2013) krijoi vlera negative dhe konkretisht gjendja kontalibe e fondit të zhvillimit pas shpërndarjes së fitimit të vitit 2013 eshte - 50.368.929 leke.

Gjate vitit 2015 jane realizuar 59.870.000 leke investime (me TVSH) dhe jane ne proces tenderimi e rcalizimi 277.500.000 leke (me TVSH), per vitin 2016 fondi i investimeve eshte parashikuar 227.400.000 leke.

Nisur nga realizimi i pritshem i fitimit qe do te krijohet mbas mbylljes se rezultatit te vitit 2015, si dhe nga fondi i zhvillimit qe pritet te krijohet arrin vleren 1.030.280.000 leke.

Fondi i investimeve do perballohet nga fondi i krijuar nga realizimi i pritshem per vitin 2015, i pritshmi i vitit 2016 dhe nga fondi i amortizimit i krijuar ne vite.

Gjithashtu eshte per tu theksuar se jo i gjithe fondi i planifikuar per tu investuar do realizohet brenda vitit 2016, per arsye se ka zera investimesh te cilat do te zgjasin ne kohe duke vazhduar edhe gjate vitit 2017 ose per arsye objektive mund te pengojne realizimin.

Duke marre ne konsiderate kerketat e drejtorive rajonale dhe nevojat e te gjithe institucionit ka ripare edhe nje here investimet e programuara nder vite (2011-2015), por qe nuk jane realizuar dhe ka bere permiresimet e nevojshme.

*I. Investimet ndertimore ne vitet 2011-2015* ishin parashikuar 583.950.000 leke, jane realizuar 21.870.000 leke, mbeten 562.080.000 leke. Investimet e programuara ne vite jane te domosdoshme, pasi ndikojne ne sherbimin ndaj qytetareve. Po permendim me kryesoret.

#### **DR Berat**

Godinë administrative, kabanon per kontrollin fizike dhe tahografin me vlere 132.800.000 lekë. Per kete investim, eshte hartuar projekti por nuk disponojme sheshin e ndertimit. (vlere e trashcguar nga vitet).

#### **D R Laç**

Godinë administrative, kabanon per kontrollin fizik dhe tahografin me vlere 108.000.000 lekë. Per kete investim eshte hartuar projekti por nuk disponojme sheshin e ndertimit, sepse sheshi aktual qe disponon kjo drejtori është në kushte të pafavorshme per ndertim (vlere e trashcguar nga vitet).

#### **D R Shkodër**



Godinë administrative, kapanon për kontrollin fizike dhe tahografin me vlerë 108.000.000 lekë. Për këtë investim, do të aplikojmë projektin që kemi për DR Laç dhe jemi në kërkim të një sheshi të favorshme për ndërtim. Kjo drejtori e ushtron aktivitetin në godinë me qera.

#### **D R Elbasan**

Shtese anesore e godines me vlerë 5.600.000 lekë. Në këtë investim (vlerë e trashëguar nga vitet) është menduar shtesë për arkivat si dhe për klasat e marrjes në prova për drejtuesit e mjeteve.

#### **Drejtoria e Përgjithshme**

**Rikonstruksion ne Drejtorine e Pergjithshme** me vlerë 13.000.000 lekë. Ky investim nuk është realizuar sepse jemi në pritje të dokumentacionit të pronësisë. Rikonstruksioni për zyrat konsiston në rritjen e ambjentëve, rreth 100m<sup>2</sup>, si dhe rikonstruksionin i brendshëm të shkalleve dhe katit të dytë të godines me të gjitha punimet e rifinitures. Ky investim nuk është realizuar për shkak të pronësisë së truallit rreth godinës (oborrit aktual).

*Investimet nderimore për vitin 2016* janë parashikuar 17.500.000 leke si më poshtë:

**DR Elbasan**, fondi prej 9.400.000 (5.600.000 në vite + 9.400.000 në vitin 2016 = 15.000.000 gjithsej) lekë me objekt "Shtesë anësore e godinës administrative" ku do të shtohet rreth 250 m<sup>2</sup> ndërtesc.

**DR Korçë**, fondi prej 1.500.000 lekë me objekt "Rikonstruksion në DR", konsiston në rikonstruksionin e çatisë, sheshin për rreth drejtorisë si dhe tenda pas godinës administrative.

**DR Kukës**, fondi prej 3.600.000 lekë me objekt "Rikonstruksion në DR", konsiston në rikonstruksionin e objekteve në hyrje të sheshit të D Rajonale për sisteminin e kontrollit në rrugë, kontrollorët fizike dhe një magazinë.

**DR Dibër**, fondi prej 500.000 lekë me objekt "Rikonstruksion i sistemit të ngrohjes", konsiston në rikonstruksionin e sistemit të ngrohjes në këtë drejtori.

**DR Tiranë**, fondi prej 300.000 lekë me objektin "Rikonstruksion dhe mirëmbajtje e sistemit të ngrohjes", konsiston në rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ngrohjes në këtë drejtori.

**DR Sarandë**, fondi prej 2.200.000 lekë me objektin "Rikonstruksion në DR", konsiston në rikonstruksionin e rrugës hyrëse brenda rrethimit të drejtorisë, sheshin përpara saj dhe një portë xhami, brenda në sallën e pritjes.

**Rikonstruksion ne Drejtorine e Pergjithshme** me shtese fondi ne vleren 7.000.000 lekë.

**II. Investimet per sistemet informatike ne vitet 2011-2015** ishin parashikuar 276.400.000 lekë . Gjate vitit 2015 jane realizuar (perfunduar tenderimi, por nuk jane likujduar) Analiza vjetore per vitin 2015



69.800.000 leke. Per vitin 2016 pas rishikimit te tyre kjo vlere është 373.300.000 leke (përfshire dhe ato të tenderuarat dhe qe nuk jane likujduar). Paraqitja e tyre eshte si me poshtë:

### **1-NDERTIMI I "DISASTER RECOVERY & BUSINESS CONTINUITY"**

Në baze te VKM Nr. 710, datë 21.8.2013 eshte e detyrueshme qe cdo institucion i cili ka sisteme te cilet mbajne te dhena dhe kryejne procese pune me sisteme elektronike eshte i detyrueshme te kete nje mbrojtje per rastet kur kemi probleme teknike.

Aktualisht DPSHTRR ka disa sisteme elektronike qe jane si ne vijim:

- Sistemi i Mjetit, taksa dhe gjoba (ka nje Disaster recovery & business continuity prane AKSHIT)
- Sistemi i lejeve te drejtimit (Nuk ka sistem mbrojtje nga demtimet)
- Sistemi i personalizimit te lejes se drejtimit (Nuk ka sistem mbrojtje nga demtimet)
- Sistemet Financiare (Nuk ka sistem mbrojtje nga demtimet)

Per arsyjen e mesiperme eshte e nevojshme te kete nje plan per secilin nga sherbimet.

### **2-BLERJE PAJISJESH INFORMATIKE PER DPSHTRR DHE DREJTORITE RAJONALE**

Nisur nga amortizimi dhe numri i proceseve elektronike ne rritje, eshte e nevojshme qe te kete nje fond per blerjen e pajisjeve dhe zëvendesimin e pajisjeve te amortizuara. Duke qenë se numri i punonjësve është i madh duhet që të parashikohet nje fond i tille edhe ne vazhdimësi

### **3-NDERTIM ACTIVE DIRECTORY-SE & ANTIVIRUS QENDROR**

DPSHTRR nuk ka nje sistem i cili do te mundësoje mbrojtjen nga viruset si dhe limitimin e të drejtave të secilit perdorues në kompjuterat ne te cilet ata punojne. Me anë te active directory-se e cila është pjese e Microsoft Windows do te ofrohet mundesia qe te kufizohen te drejtat e perdoruesve dhe kjo do ofroje nje siguri shume te larte ne te dhenat si dhe do ofroje mundesine e portabilitetit nga njeri kompjuter ne nje tjetër.

Antivirusi qendror do te ule kostot per drejtorin per programe mbrojtese nga viruse si dhe do te kemi nje sistem te qenderizuar i cili nuk do gjeneroje trafik per updatimi si dhe per cdo kompjuter do te jete e mundur update-imi ne sistem lokal dhe jo nga internetit qe mbase jo cdo perdorues duhet te kete akses.

### **4-NDERTIMI I ARKIVES ELEKTRONIKE**

Arshiva elektronik eshte nje sistem i domosdoshem sepse me ane te ktij sistemi do te realizohet eliminimi i kontaktit me dokomunetacionin fizik dhe do te jete e mundur qe te dhenat te kontrollohen ne menyre shume te thjeshte per cdo perdorues i cili ka te drejta.



Ky sistem duhet te organizohet ne dy faza,

- Sistemi i dokumentacionit te ri (fondi i kerkuar i perket kesaj pike).
- Sistemi i dokumentave ekzistuese e cila do te behet ne arshiven kombetare ne DR Dures.

#### **5-ZHVILLIME DHE PERMIRESIME TE SISTEMEVE EGZISTUESE SIPAS NDRYSHIMEVE LIGJORE**

Duke qene se ka pasur apo mund te ndodhin ndryshime ne kodin rrugor e ligje te tjera dhe ne aktet nenligjore duhet te parashikohen ndryshime ne sistemet ekzistuese aktuale te DPSHTRR-së.

#### **6-INTEGRIMI I SISTEMIT TE SHERBIMEVE NE INSTITUCIONET E TJERA NEPERMJET PORTALIT MULTIFUNKSIONAL E-ALBANIA.AL**

Ne baze te detyrimeve te lidura nga VKM-ja per portalin e-Albania, DPSHTRR do te jete pjese e portalit si me lejet e drejtimit, mjetin, CAP, etj. Per te realizuar komunikimin dhe nderverprimin me portalin e e-Albania eshte e nevojshme te ndertohet ifrastuktura e pajisjeve elektronike dhe ndertimi i sisteveme softëware per te ofruar nje shembim sa me te shpjete ndaj qytetareve.

#### **7-INTEGRIMI I SISTEMEVE TE LEJES SE DREJTIMIT, DESHMIVE DHE ÇERTIFIKATAVE(MAKINERI, HW DHE SW)**

Ndryshime ne kodin rrugor me shitimin e kategorive si dhe amortizimi pothuajse i plote i sistemit aktual te personalizimi (sistem qe eshte ndertuar qe ne 2004) eshte e nevojshme blerja e makinerive te reja, sistemi elektronik te ri si dhe riorganizim i plote i proceseve. Per te ulur kosto DPSHTRR do te kerkoje qe te personalizojc jo vetem lejet e drejtimit por edhe dokumenta te tjere si deshmite e ndryshme.

#### **8-PROGRAM PER MONITORIMIN E BURIMEVE NJERZORE**

#### **9-SISTEM ELEKTONIK I RADHE PER SHERBIMET NDAJ QYTETAREVE**

#### **10-QENDERZIM DHE INTEGRIM I PROGRAMIT FINANCIAR**

#### **11-KRIJIMI I REGJISTRIT ELEKTRONIK PER OFICINAT E TAHOGRAFIT**

#### **12-UPGRADE I SISTEMIT QENDROR edpshttr,**

Paisjet HW dhe aplikimit edpshttr

Ridizenjim i infrastruktures HW dhe ndertimi i sistemit te menaxhimimit

Upgrade i sistemeve operative te serverave dhe databazes edpshttr

Upgrade i sistemit informatik edpshttr, permisim i funksionaliteteve aktuale, shtim sherbimesh.



### **13-BLERJE PJESE DHE PAISJE PER SEVER ROOM**

Pjese per sistemin e kondicionimit, te sistemit te alarmit dhe zjarrit

*Investimet per makineri e pajisje dhe inventar ekonomik ne vitet 2011-2015* ishin parashikuar 42.500.000 leke, jane realizuar rreth 20.000.000 leke, mbeten 22.500.000 leke. Pas rishikimit te tyre kjo vlere per vitin 2016 eshte parashikuar te jenc rreth 54.400.000 leke.

**Problemet e trajtuara 2015 e per ndjekje ne vazhdim gjate vitit 2016.**

Me ndryshimet në ligjin nr.9975 "Per taksat Kombetare" i ndryshuar dhe përkatësisht vendosja e takses per makina luksoze nga ana jone ne bashkepunim me DATI-n janë marre masat duke bere dhe ndryshimet perkatese ne programet informatike qe me hyrjen ne fuqi te ligjit te behej i mundur arketimi i kesaj takse. Ne bashkepunim me DRM eshte punuar per te evidentuar te gjitha mjetet e regjistruara qe kane nje vlere te blerjes me te madhe ose te barabarte me 7.000.000 leke per vjeljen e TVML per keta mjete.

Njekohesishte eshte bere dhe permisimi i modelit te evidencave qe nga ana e Drejtorive Rajonale te jepet nje informacion sa me i plote dhe i sakte per treguesit ekonomiko financiar, numrin e veprimeve te ardhurat dhe shpenzimet per çdo sektor.

Eshte saktësuar menyra e faturimit te TVMP-se dhe TVML-se si dhe menyra e raportimit te ketyre taksave, kjo ne bashkepunim dhe me Organet Taimore.

Po punohet për përmiresimin e programeve informatike dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet ligjore.

Njekohësishtë po punohet per qenderzimin e programit financiar të Drejtorive Rajonale me atë të DPSITRR-së.

Eshtë bërë perpunimi i shkresave te ardhurave, duke kthyer pergjigje sipas problematikave të hasura gjatë punes si për ndjekjen e debitoreve, dhënia e vertetimeve për subjektet fizike e juridike etj.

Eshte hartuar Programi Ekonomiko Financiar i DPSITRR-se per vitin 2016 i cili është miratuar në Keshillin Drejtues dhe nga Ministria e Transportit dhe e Infrastruktures, si dhe u është derguar Drejtorive Rajonale per zbatim.

Eshte punuar dhe dhene mendim ne lidhje me Projekt-Ligjet apo Projekt-Udhezimet te cilat jane kerkuar nga ana e Ministrise se Financave apo Ministria e Transportit dhe e Infrastruktures, per pjesen qe i takon drejtorise ekonomike.

### **DREJTORIA E REGJISTRIMIT TË MJETEVE LICENSIMIT DHE CERTIFIKIMIT**

Drejtoria e Regjistrimit të Mjeteve, Liçensimeve dhe Çertifikimit është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor që mbulon aktivitetin e të gjithë shërbimeve që lidhen me mjetet rrugore në Republikën e Shqipërisë si dhe me dhënien e liçensave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e transportit rrugor.

DRMLÇ ka në strukturë:

Analiza vjetore per vitin 2015



Drejtori i Drejtorisë  
Sektori i Regjistrimit të Mjeteve  
Sektori i Liçensimeve  
Sektori Shërbimit Tahograf  
Sektori i Arkivit Kombëtar

### Sektori i Regjistrimit të Mjeteve

Gjatë vitit 2015, përveç rutinës burokratike me shkresat, është punuar edhe në drejtim të arritjes së disa objektivave në funksion të rritjes së performancës dhe përmirësimit të shërbimit nga degët e regjistrimit të mjeteve në drejtoritë rajonale. Konkretisht :

1. U ripunua **Rregullorja e DRMLÇ**, duke bërë azhurnimin e saj dhe pasqyrimin e ndryshimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me veprimtarinë e drejtorisë me riorganizimin e strukturës së re të DPSHTRr;
2. Janë miratuar të gjitha **rregulloret e brendshme të drejtorive rajonale** dhe pritët vetëm kalimi në Këshillin Drejtues ;
3. Janë propozuar disa shtesa ne kodet e karrocërive të mjeteve rrugore, në funksion edhe të kërkesave dhe konsultimeve me specialistët e drejtorive rajonale. Mbetet në fuqi synimi për përgatitjen e një materiali për unifikimin e tyre me ato të vendeve të BE-së ;
4. Për të realizuar me sukses shërbimin ndaj qytetarëve në veprimet e përditshme për zbatimin e këtyre rregulloreve, janë organizuar trajnime dhe testime të specialistëve të shërbimit për të gjithë drejtoritë rajonale;
5. Për mjetet motorike të trafikuar, komunikimi ka vazhduar me korrektësi në zbatim të marrëveshjes me DP Policisë dhe konkretisht me **Interpol Tiranë**. Asnjë mjet nuk kryen çfarëdo lloj shërbimi në DPSHTRr pa u verifikuar në sistemin ASF2 të Interpol-it.
6. Janë propozuar disa ndryshime në Kodin Rrugor dhe VKM nr. 153, Rregullore në zbatim të Kodit Rrugor, në koordinim me Drejtorinë e Sigurisë dhe Qarkullimit Rrugor në MTI ;
7. Në kuadër të luftës kundër informalitetit, draft-udhezimi i propozuar nga ne është miratuar si udhëzim i përbashkët i tre ministrive, MTI, MPB dhe MD për ndërrimin e pronësive së mjeteve rrugore. Pritet vetëm të publikohet në fletoren zyrtare ;
8. Pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në Kodin Rrugor, kryesisht për ndalimin e regjistrimit të mjeteve motorike me timon në krahun e djathtë, janë krijuar shqetësime të vazhdueshme, por që falë bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimeve është arritur të gjendet zgjidhja për të gjitha rastet e paraqitura për shërbim.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Informacionit kemi realizuar seanca trajnime për punonjësit e pranimit dhe specialistët e kontrollit fizik për shtesat në programin e ri informatik të regjistrimit të mjeteve. Ky bashkëpunim vazhdon dhe është i përditshëm në çdo moment me punonjësit nëpërmjet kontakteve telefonike për çdo paqartësi dhe vështirësi gjatë punës.



Korrespondenca me MTI-në dhe kryesisht me Drejtorinë e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore ka qenë e rregullt kryesisht e motivuar edhe me problematikat e dosjeve të mjeteve të mbartura në vite. Shqetësimet e lindura për shërbime të caktuara nëpër drejtoritë rajonale u janë bërë prezent specialistëve në MTI me qëllim gjetjen e zgjidhjeve ligjore. Pas automatizimit të shërbimeve në degët e regjistrimit të mjeteve, ka vazhduar evidentimi i mjeteve me të njëjtin numër identifikimi. Njëkohësisht edhe mjetet e evidentuara të vjedhura në ASF2, por që rikthehen për shërbim me vendime pushimi të çështjes nga Prokuroria ose Gjykata vazhdojnë të përbëjnë shqetësim.

Jane propozuar një sere ndryshimesh në sistemin informatik e-DPSHTRR, kryesisht edhe lejimin e disa shërbimeve për mjetet që rezultojnë pozitiv në ASF2.

Gjatë vitit 2015 nga Sektori i Regjistrimit të Mjeteve në bashkëpunim dhe me Drejtorinë të tjera janë realizuar disa përmirësime të bazës ligjore për procedurat e ndryshme administrative, të cilat kanë të bëjnë me të gjitha shërbimet që ofrojnë degët e regjistrimit të mjeteve në Drejtoritë Rajonale dhe njëkohësisht mirëorganizimin e punës në këto Degë. Kjo veprimtari ka synuar si më poshtë:

1. Është revokuar dhe rifuqizuar pjesërisht Udhezimi nr. 7, datë 17.06.2014 "Për ndryshimin e karakteristikave konstruktive dhe funksionale të mjeteve rrugore". Aktualisht shërbimi vazhdon sipas përcaktimeve në këtë udhëzim deri në një njoftim nga MTI;
2. Jane unifikuar në masën 90% dokumentet e regjistrimit për mjetet e reja me 0 km, të quajtura ndryshe CoC, certifikatat e konformitetit.
3. Regjistrimi i mjeteve që importohen nga Italia me konfirmimin nga baza e të dhënave të ACI drejtpërdrejt në faqen e internetit.

Gjatë vitit 2015 janë realizuar kontrole të planifikuara vetëm në disa Drejtori Rajonale, pa arritur të kryhen sipas programit të planifikuar për arsye të ndryshme. Parashikojmë që në vitin në vazhdim të angazhohemi në grupe kontrolli të planifikuara ose jo në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspeklimit dhe të Auditit me qëllim rritjen e performancës së shërbimit dhe zbatimin korrekt të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e regjistrimit të mjeteve rrugore.

Gjatë vitit 2015 janë përgatitur 69 materiale për ristampim të numrave të identifikimit, nga 104 raste gjatë vitit 2014, me një ulje prej 35%.

Për mjetet me të njëjtin numër identifikimi por që kanë rezultuar nga ekspertiza shkencore si të rregullt, për të gjitha këto raste është pezulluar shërbimi deri në një përgjigje nga DP Policisë së Shtetit.

Në lidhje me shkresat për probleme të ndryshme, që i përkasin sektorit tonë, kemi dhënë përgjigjet përgjithësisht brenda afateve optimale. Për vitin 2015 janë përgatitur mbi 249 shkresa me institucione shtetërore dhe private për probleme të ndryshme.

Komunikimi me Drejtoritë Rajonale gjatë vitit 2015 për probleme të ndryshme është bërë me shkresa të protokolluara, numri i të cilave kalon mbi 310 shkresa, ku evidentohet rritje në krahasimi me vitin 2014, kryesisht për llogari të çregjistrimeve të gabuara si dhe mjeteve



që vijnë dhe verifikohen nga rezervat e shtetit. Po ashtu edhe me drejtorinë në DPShTRr me shkresa të brendshme ku janë dërguar rreth 168 të tilla.

Ashtu si vitin e kaluar ritheksojmë faktin që në rastet kur nga degët e regjistrimit të mjeteve kërkohet një mendim më i specializuar për shërbime me mjete që nuk parashikohet në procedurë, është e domosdoshme shprehja e argumentuar e mendimit të specialistëve të degës përkatëse për zgjidhjen që propozojnë.

### Spektori i Liçensimit

Spektori i Liçensimit dhe Çertifikimit është pjesë përbërëse e DRI.MÇ-se ne Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor që mbulon aktivitetin në të gjithë shërbimeve që lidhen me dhënie e liçensave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e transportit rrugor të cilat janë:

1. Liçence për Transport të Mallrave me Mjete Jashtë Norme
2. Çertifikate për Transport Rrugor Nderkombëtar Mallrash për të Tretë dhe me Qira
3. Çertifikate ECMT e Kontrollit Teknik vjetor për mjetet motorrike dhe rimorkjot
4. Çertifikate ECMT e Përputhjes për Rimorkjot me normat teknike të sigurisë
5. Çertifikate miratimi ADR, për mjetet që transportojnë disa mallra të rrezikshme.

Gjatë vitit 2015 janë marrë në shqyrtim dokumentacioni i 2 subjekteve juridike për liçence për transport të mallrave me mjete jashtë norme. Vlera për keto liçenca është 40.000 leke. Gjatë këtij viti, në Qendrën Kombëtare të Liçensimit, kanë paraqitur kërkesën për tu liçensuar në fushën e transportit rrugor ndërkombëtar të mallrave për të tretë dhe me qera 72 subjekte juridike dhe fizike, të cilët kanë kërkuar të ushtrojnë aktivitetin e tyre për herë të parë në këtë fushë.

Komisioni i DPShTRr-së, i ngritur me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, në zbatim të Ligjit Nr. 10018, datë 23.02.2009 "Për liçensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM-së Nr. 538, datë 26.05.2009 "Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga, apo nëpërmjet QKL – së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta" në zbatim dhe të Udhëzimit Nr.15, datë 24.07.2007, të MPPT "Për kriteret dhe Procedurat e lëshimit të liçensave, autorizimeve dhe çertifikatave, për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", pasi ka shqyrtuar rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur nga personat fizike dhe juridike pranë QKL-së, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, ka bërë miratimin e 49 kërkesave për liçensim nga subjektet, në 23 raste është bërë refuzimi dhe në rastet kur është plotësuar dokumentacioni është bërë miratimi i tyre.

Vlera për keto liçenca është 1.470.000 leke.

Gjatë vitit 2015 janë lëshuar 1257 Çertifikata për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qera nga 886 të lëshuara gjatë vitit 2014.

Vlera për keto çertifikata është 9.466.943 leke .

Gjatë vitit 2015 janë lëshuar 835 Çertifikata ECMT e Kontrollit Teknik vjetor për mjetet motorrike dhe rimorkjot nga 796 për vitin 2014 dhe 94 Çertifikate ECMT e Përputhjes për Rimorkjot me normat teknike të sigurisë nga 90 për vitin 2014. Këtë vit



jane lëshuar 43 çertifikata me shume me nje vlere prej 64.500 lekesh me shume se viti 2014.

Ne muajin Nentor filloi zbatim i udhezimit nr.6, datë 27.5.2015, "Për procedurat e inspektimit të mjeteve, lëshimit të çertifikatës së miratimit ADR, kushtet që duhet të plotësojë personi juridik për inspektimin e mjeteve ADR dhe tarifat e shërbimit", duke lëshuar 170 çertifikata ADR, per te cilat eshte bere inspektimi i mjeteve nga qendra e licencuar. Vlera per shqyrtimin e dokumentacionit per keto çertifikata eshte 680.000 leke.

Ne baze te Udhezimit nr.12, date 19.07.2007, pika 7 Zyrat e transportit ne Bashki dhe Komuna kane derguar kerkesat e tyre per pajisjen me Licenca per autoveturave taksi 4+1 vende dhe 8+1 vende. Keto kerkesa jane percjelle prane DTSH brenda afateve.

Sektori i Licencimit dhe Çertifikimit ka komunikuar me Drejtorine e Administrimit te Teknologjise dhe Informacionit per venjen ne funksionim te programit edpshttr-se i cili ben te mundur leshimin e çertifikatave dhe ne Drejtorite Rajonale ne menyre elektronike. Gjithashtu me kete drejtori ka bashkepunim per krijimin e Regjistrat Elektronik Kombetar te Ndermarrjeve ne Transportin Rrugor .

### **Sektori i Shërbimit të Tahogرافit**

Puna e Sektorit të Tahogرافit, për vitin 2015 është përqëndruar në dy drejtime kryesore;

- a. Në stabilizimin dhe vazhdimin e aplikimit dhe prodhimit të kartave memorjes për tahogرافët dixhital dhe;
- b. Në funksionimin dhe kryerjen e shërbimit në përputhje me kërkesat ligjore, me kompetencë profesionale me cilësi dhe në një kohë sa më të shkurtër në oficinat e tahogرافëve në Drejtoritë Rajonale Fier, Vlorë, Gjirokastrë. Gjatë këtij viti kemi ndjekur dhe plotsimin e kushteve për të marrë autorizimin për oficinën e tahogرافit të Drejtorisë Rajonale Durrës, ku deri më tani nuk na është dhënë.

#### **A.Aplikimi dhe prodhimi i kartave të memorjes për tahogرافët dixhital**

Kontrata për prodhimin e kartave të memories për tahogرافët dixhital me nr. 10-017CCH është lidhur me datë 10 Shkurt 2010 me kompaninë CRONOSERVICES ka përfunduar me datën 12 Korrik 2015 dhe nga ajo datë e deri më sot nuk kemi prodhuar asnjë copë kartë elektronike për tahogراف dixhitalë.

Gjatë muajit Janar e deri më 15 Shkurt 2015 kemi punuar me specialistët e MTI për të përcaktuar mënyrën e prodhimit dhe personalizimit të kartave elektronike për tahogرافët dixhital.

Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës me shkresën 1063, datë 17.02.2015 kërkon që për të garantuar vazhdimësinë e funksionimit të sistemit të tahogرافit dixhital të filloj përgaditja e procedurave standarte të prokurimit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme të këtij sistemi.



Me grup punë filluam të hartojmë termat e referencës dhe specifikimet teknike për prodhimin dhe personalizimin e kartave elektronike për tahograf dixhital dhe i kemi përfunduar në fillim të muajit Qershor 2015.

Është zhvilluar tenderi me datë 28 Shtator 2015 dhe asnjë nga konkurentët nuk ka plotësuar kërkesat tekniko ligjore për prodhimin e kartave.

Në këto kushte u bënë pregaditjet për shpalljen përsëri të këtij tenderi I cili do të zhvillohet me datën 03 Mars 2016.

Nga 01 Janari 2015 e deri më 12 Korrik të këtij viti janë prodhuar dhe shpërndar gjithësejt 481 karta elektronike tahografi dixhital nga të cilat 401 copë KDM, 40 copë KSH, 33 copë KKN dhe 7 copë KO.

Në periudhën janar mars 2015 si sektor kemi ndjekur dhe prodhimin e certifikatave të kryerjes së operacioneve teknike dhe materialeve të tjera që duhen për ofiçinat e tahogرافit sipas kërkesave të udhëzimit të MTI. Gjatë kësaj periudhe e deri në fund të muajit Maj kemi bashkëpunuar me kompaninë Velmar për të përshtatur programet në ofiçinat e tahogرافit Fer, Vlorë dhe Gjirokastër sipas modelit të certifikatës së re dhe gjatë muajit u implement plotësisht.

**B. Në funksionimin dhe kryerjen e shërbimit në përputhje me kërkesat ligjore, me kompetencë profesionale me cilesi dhe në një kohë sa më të shkurtër në ofiçinat e tahogرافeve në Drejtorinë Rajonale Fier, Vlorë, Gjirokastër. Gjatë këtij viti kemi ndjekur dhe plotësimin e kushteve për të marrë autorizimin për ofiçinën e tahogرافit të Drejtorisë Rajonale Durrës, ku deri më tani nuk na është dhënë.**

#### **1. Në drejtorinë Rajonale Fier**

Gjatë këtij viti pra nga 1 Janar deri me 31 Dhjetor 2015 janë kryer 307 kontrole tahografi nga të cilat 12 inspektive 2 vjeçare dhe 295 kalibrime.

Gjatë këtij viti kanë rënë shumë kërkesat për shërbime, por kjo ofiçinë nga data 08 Shtator e deri me 15 Dhjetor 2015 nuk ka punuar pasi nuk ju bë rinovimi i Autorizimit të ofiçinës.

Specialistët e tahogرافit në këte qendër janë të aftë dhe kanë përballuar mirë të gjitha problemet që janë hasur në tipe të ndryshme tahogرافësh. Linja dhe programi i pajisjes kontrollit dhe kalibrimit kanë funksionuar mirë dhe kanë realizuar procedurat e kërkuara.

#### **2. Në Drejtorinë Rajonale Gjirokastër**

Nga 01 Janar deri në 31 Dhjetor 2015 në këtë drejtori janë kryer 189 kontrole tahografi nga të cilat 20 inspektive 2 vjeçare dhe 169 kalibrime.

Gjatë këtij viti kanë rënë shumë kërkesat për shërbime, por kjo ofiçinë nga data 08 Shtator e deri me 15 Dhjetor 2015 nuk ka punuar pasi nuk ju bë rinovimi i Autorizimit të ofiçinës.



Specialistët e tahogرافit në këte qendër janë të aftë dhe kanë përballuar mirë të gjitha problemet që janë hasur në tipe të ndryshme tahogرافësh. Linja dhe programi i pajisjes kontrollit dhe kalibrimit kanë funksionuar mirë dhe kanë realizuar procedurat e kërkuara.

### **3. Në Drejtorinë Rajonale Vlorë**

Autorizimi për këtë oficinë është dhënë me datë 15 Dhjetor 2014, kanë vazhduar procedurat e liçensimit të programit montimi dhe kolaudimi i tij dhe puna ka filluar me datë 06 Janar 2015.

Nga 01 Janar deri në 31 Dhjetor 2015 në këtë drejtori janë kryer 245 kontrolle tahogرافي nga të cilat 103 inspektime 2 vjeçare dhe 142 kalibrime.

Procedurat në përgjithësi kanë vazhduar normalisht. Specialistët e tahogرافit në këtë qendër kanë njohuri të mira për përballimin e problemeve që dalin në tipe të ndryshme tahogرافësh. Linja dhe programi i pajisjes kalibrimit kanë funksionuar mirë dhe kanë realizuar procedurat e kërkuara.

### **4. Në Drejtorinë Rajonale Durrës**

Me datë 11 Nëntor 2014 kanë qenë specialistet e Sektorit Tahogرافit në këtë Drejtori, situata nuk ishte e kënaqshme dhe kishte probleme për vendosjen e kësaj linje në punë. Të gjitha problemet janë diskutuar me drejtuesit e kësaj Drejtorie dhe u lanë detyra konkrete për pregaditjen e linjës për prova testuese. Nga specialistët e Sektorit të Tahogرافit u muar njësia e dëmtuar e kompjuterit dhe u dërgu tek specialistët e Velmarit për riparim dhe instalimin e programit dhe disa nga mangësitë nga Drejtoria Rajonale ishin rregulluar, nuk ishte bërë instalimi elektrik për montimin e kompresorit dhe monitorit 32 polsh.

Me datë 24 Nëntor 2014 u riparua njësia dhe është bërë montimi i programit dhe janë kryer provat pa ngarkesë të sistemit i cili ka funksionuar mirë.

Dosja e kësaj oficine është dërguar tek specialistët e Ministrisë që me 13 Nëntor 2014. Që nga ajo kohë e deri në fund të vitit 2015 është inspektuar dhe 2 herë të tjera nga specialistët e MTI dhe akoma nuk është dhënë autorizimi.

Për të gjitha oficinat teknike mbeten problem sigurimi i fishave nga ana e kompanisë kontraktuese Velmar për tahogرافët 1319 dhe EEG 100 Volvo, ku megjithë kërkesat tona të herëpashershme me gojë dhe shkrim nuk i kanë siguruar.

### **C. Sigurimi i bazës së nevojshme materiale për qendrat teknike të tahogرافit**

Në vazhdimësi kemi ndjekur dhe sigurimin e bazës materiale për oficinat e tahogرافit, kemi bërë në kohë specifikimet teknike të tyre, por edhe kontrollin pas furnizimit dhe shpërndarjen e tyre në drejtorinë rajonale.



## DREJTORIA E DREJTUESVE TË MJETEVE

Drejtoria e Drejtuesve të Mjeteve si strukturë e DPSHTRR-së, përbëhet nga 3 sektorë që janë:

- Sektori i kontrollit të autoshkollave;
- Sektori i drejtuesve të mjeteve;
- Sektori i arkivave të lejeve të drejtimit.

Puna e Drejtorisë së Drejtuesve të Mjeteve, për vitin 2015, është përqendruar në realizimin e objektit të veprimtarisë së saj që është:

- Hartimi i projekteve për përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e drejtimit të mjeteve;
- Përgatitja e rregulloreve, procedurave, urdhërave si dhe dhënie mendimesh për përmirësimin e strukturës;
- Kontrolli për zbatimin e procedurave, në shërbim të qytetarëve, për lëshimin e lejedrejtimit, rimarrjen e lejedrejtimit, konvertimin e lejedrejtimit etj.;
- Kontrolli i veprimtarisë së subjekteve autoshkollë;
- Hartimi dhe kontrolli për zbatimin e procedurave për funksionimin e arkivës dhe regjistrit kombëtar të drejtuesve të mjeteve.

### **I. PËRMIRËSIMI I AKTEVE LIGJORE E NËNLIGJORE**

Nga Drejtoria e Drejtuesve të Mjeteve janë bërë:

#### **1. Propozime Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës:**

- Për hartimin e Draft -VKM në zbatim të Kodit Rrugor “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 153, datë 7.4.2000, të ndryshuar”;
- Për hartimin e Draft-Udhëzimit “Mbi aktivitetin e autoshkollave për përgatitjen e kandidatëve për drejtues mjeci...”;
- Për hartimin e Draft-Udhëzimit “Mbi karakteristikat e materialit, elementët e sigurisë, elementët grafikë dhe mënyrën e plotësimit të lejedrejtimit të ri të mjeteve rrugore”;
- Për miratimin e modelit të ri të Lejedrejtimit Ndërkombëtare, mbështetur në Konventën e Qarkullimit Rrugor të Vienës, e 8 Nëntorit 1968, në bazë të së cilës palët pjesëmarrëse të Konventës, duke filluar nga data 29 Mars 2011, brenda 5 vjetëve duhet të lëshojnë Lejedrejtimi Ndërkombëtare, model i ri;
- Për ngritjen e komitetit të posaçëm teknik i cili duhet të nxjerre rregullat për komisionet mjekësore vendore lidhur me lëshimin e lejedrejtimit të posaçme, në zbatim të Kodit Rrugor, neni 117, pika 9. Nga ana jonë është kërkuar që MTI të nxjerrë rregullat për Komisionet mjekësore vendore lidhur me plotësimin e



Certifikatave Mjekësore dhe kodeve të harmonizuara për drejtuesit e mjeteve dhe mjetet”.

**2. Përgatitja e rregulloreve, procedurave dhe urdhërave të ndryshëm:**

- Rregullore nr. 1, datë 03.03.2015 “Për funksionimin e sektorit të kontrollit të autoshkollave në drejtorinë rajonale Tirane;
- Rregullore nr. 2, datë 27.5.2015 “Për procedurat e testimit të kandidatëve për drejtues mjeti, aplikantëve për rifitim të pikëve dhe për marrjen e dëshmisë së taksistit”;
- Rregullore nr. 04, datë 02.07.2015 “Për kryerjen e shërbimeve ndaj qytetarëve në sektorin e drejtuesve të mjeteve”;
- Rregullore nr. 8, datë 28.12.2015 “Për funksionimin e degës së drejtuesve të mjeteve në DRSHTRR Tiranë”;
- Rregullore nr. 1, datë 6.1.2016 “Për funksionimin e degës së drejtuesve të mjeteve në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor”;
- Rregullore nr. 2, datë 6.1.2016 “Për funksionimin e Drejtorisë së Drejtuesve të Mjeteve të DPSHTRR”;
- Mbi procedurat për lëshimin e lejedrejtimit të hequr;
- Mbi procedurat për transferimin e dosjeve nëpërmjet kërkesës me e-mail;
- Mbi procedurat e pranimit të Certifikatave Mjekësore dhe Dëshmisë së Aftësisë Psikofizike;
- Mbi procedurat për lëshimin e faturës nga sistemi e-form;
- Përgatitja e Urdhërit për kryerjen e aplikimit nëpërmjet formularit elektronik;
- Përgatitja e Urdhërit për zhvendosjen e Zyrave të Degës drejtuesve të mjeteve të DRSHTRR Tiranë;;
- Përgatitja e Urdhërit për procedurat e marrjes në prova të teorisë dhe të praktikës etj ;

Si rezultat i zbatimit të ndryshimeve ligjore e nënligjore si dhe procedurave të përmendura më sipër është mundur thjeshtimi i dokumenteve në procedurat e kryerjes së shërbimeve që konsiston në:

- a) Vërtetim banimi, është hequr;
- b) Grupi i gjakut dhe Rehzusi, është hequr;
- c) Certifikata mjekësore është bërë me afat vlefshmërie jo më të hershme se 6 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrim (nga 3 muaj që ka qenë më parë).
- d) Afatet e vlefshmërisë së lejedrejtimit dhe moshat, kanë ndryshuar.

## **II. SHËRBIMET E KRYERA NGA DEGËT E DREJTUESVE TË MJETEVE NË DREJTORIË RAJONALE**

Nga analizat e bëra në Drejtorinë Rajonale u konstatua se në përgjithësi është bërë një punë e mirë. Bazuar në pasqyrën e mëposhtme vihet re që volumi i punës është 17% më i madh në krahasim me vitin 2014, ose janë kryer 70482 veprime më shumë se në vitin 2014.



## Sasia e veprimeve të kryera për vitet 2014 dhe 2015

| Nr | Emërtimi i shërbimit                             | Viti<br>2014  | Viti<br>2015  | Rritja       | Ritja<br>në % |
|----|--------------------------------------------------|---------------|---------------|--------------|---------------|
| 1  | Nr. i personave të regjistruar në teori          | 42621         | 46607         | 3986         | 9             |
| 2  | Nr. i personave që kanë hyrë në teori            | 80073         | 94334         | 14261        | 18            |
| 3  | Nr. i personave të regjistruar në praktikë       | 38080         | 45904         | 7824         | 20            |
| 4  | Nr. i personave që kanë hyrë në prova praktike   | 62792         | 78364         | 15572        | 25            |
| 5  | Nr. personave, fitues në praktikë, pajisur me LD | 52231         | 65907         | 13676        | 26            |
| 6  | Nr. personave që kanë rinovuar LD                | 55395         | 66674         | 11279        | 20            |
| 7  | Nr. personave të pajisur me DAP                  | 515           | 554           | 39           | 7             |
| 8  | Nr. personave të pajisur me LD Ndërkombëtare     | 60091         | 62613         | 2522         | 4             |
| 9  | Nr. dosjeve të transferuara                      | 7206          | 8529          | 1323         | 18            |
|    | <b>Shuma e veprimeve të kryera</b>               | <b>399004</b> | <b>469486</b> | <b>70482</b> | <b>17</b>     |

## Të ndryshme

|                                                |                                                                                               |        |  |  |
|------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------|--------|--|--|
| Nr. personave të pajisur me lejedrejtimi       | 717688                                                                                        | 758800 |  |  |
| Nr. i autoshkollave                            | 287                                                                                           | 300    |  |  |
| Nr. shtetasve që u janë hequr pikë             |                                                                                               | 6607   |  |  |
| Nr. i shtetasve që u është hequr L.D           |                                                                                               | 66     |  |  |
| Sasia në % e pajisjes me LD sipas kategorive   | A-3%, B-85%, C-6%, D-2%, E-2%                                                                 |        |  |  |
| Volumi i punës në %, sipas Drejtorive Rajonale | BR-4, DR-13, EL-9, FR-9.5, GJ-2, KO-5.4, KU-2.8, LA-5, DI-3.8, SH-7.5, TR-32, VL-4.5, SR-1.5. |        |  |  |



Kalueshmëria e kandidatëve në provimin e teorisë është 64.5%, afërsisht e njëjtë me atë të vitit 2014

Kalueshmëria e kandidatëve në provimin e praktikës është 84%, nga 83.2% që ka qenë në vitin 2014.

Nga 66 persona që u është hequr lejedrejtimi 20 veta janë paraqitur pranë DR dhe janë regjistruar për ta rimarë atë. 20 personat janë futurë në provim 37 herë. Kalueshmëria 54%. Të 20 personat e kanë rimarë atë. 46 persona nuk janë paraqitur për tu regjistruar në provim të kualifikimit teorik, për të rimarë lejedrejtimin.

Këtu vlen që të përmendet se në rritjen e rezultateve dhe cilësinë e shërbimit të qytetarëve kanë ndikuar dhe arsyet e bëra për vitin 2015 të cilat janë si më poshtë:

1. Është realizuar aplikimi elektronik për pajisje me lejedrejtimi, fotografimi, gjurma e gishtit dhe nënshkrimi elektronik i aplikantëve dhe transmetimi i të dhënëve on- line në procesin e prodhimit të lejedrejtimit, duke rritur 100% shkallën e sigurisë dhe duke shkurtuar disa herë kohën e shërbimit ndaj qytetarëve;
2. Është informatizuar aplikimi i kandidatëve para testimit të teorisë. Ky sistem ka rritur sigurinë e kontrollit të kandidatëve që hyjnë në testin e teorisë;
3. Është në proces informatizimi i regjistrit kombëtar të drejtuesve të mjeteve;
4. Është realizuar programi informatik i faturimit elektronik të tarifës së lejedrejtimit;
5. Është realizuar programi informatik, mbi lejedrejtimin me pikë, në bashkëpunim me policinë e shtetit;
6. Është informatizuar dhe po zbatohet testimi i teorisë për dëshminë e taksistit, me të njëjtën procedurë si ajo e testimit të teorisë për pajisjen e kandidatëve me lejedrejtimi;
7. Është bërë azhurnimi i faqes zyrtare të DPSHTRR lidhur me të gjitha ndryshimet e fundit ligjore dhe nënligjore si dhe procedurat e shërbimeve ndaj qytetarëve etj;
8. Janë prodhuar dosje, nëndosje, fashikuj të ri të cilët i përgjigjen më mirë kërkesave për sistemin e dokumenteve;
9. Janë organizuar seminare me specialistët përkatës "Për zbatimin e ndryshimeve ligjore, udhëzimeve dhe rregulloreve"

### III. KONTROLLI I ZBATIMIT TË PROCEDURAVE NË DREJTORITË RAJONALE

Drejtorja e Drejtuesve të Mjeteve ka organizuar kontrolle në Degët e drejtuesve të mjeteve të Drejtorive Rajonale me synim zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, urdhërave dhe shkresave të Drejtorit të Përgjithshëm.

#### 1. Sektori i kontrollit të autoshkollave

Objekt kontrolli i këtij sektori është:

- zbatimi i akteve ligjore e nënligjore, rregulloreve, urdhërave dhe shkresave të Drejtorit të Përgjithshëm;

Analiza vjetore për vitin 2015



- dokumentacioni për licencim dhe aftësinë profesionale të personelit të autoshkollave;
- dokumentacioni për administrimin e aktivitetit të autoshkollave;
- procedurat e regjistrimit të kandidatëve për drejtues mjeti dhe të provave të teorisë e të praktikës;
- zbatimi i procedurave të testimit teorik dhe praktik të kandidatëve për drejtues mjeti.

Për vitin 2015 kanë ushtruar aktivitetin për përgatitjen e kandidateve për drejtues të mjeteve rrugore në të gjitha Drejtoritë Rajonale 300 subjekte Autoshkollë, me 900 mjete të autorizuar për të gjitha kategoritë e lejedrejtimit.

Gjatë vitit 2015, Sektori i Kontrollit të Autoshkollave ka realizuar kontrole në Drejtoritë Rajonale Tiranë, Elbasan, Peshkopi, Durrës, Kukës mbi dokumentacionin e subjekteve Autoshkollë, mjetet e stërvitjes praktike pajisja me autorizimin nga ana e DRSHTRR-se, pajisja me komandat e dyfishta, pajisja me shenjen dalluese "AUTOSHKOLLE", ambientet e mësimdhënies (klasat) kapaciteti, kushtet higjeno-sanitare, pajisja me mjete didaktike dhe maket, pajisja me mjete audio-vizive dhe kompjutera, mësuesit dhe instruktorët e praktikës, zhvillimin e seancave të mësimi teorik dhe praktik dhe kontrollin e regjistrave të kandidatëve, procedurat e marrjes në prova teorike dhe praktike të tyre.

Në kontrollat e kryera janë lënë detyra dhe afate për të bërë përmirësimet e nevojshme.

Si rezultat i kontroleve është vënë re që dokumentacionet e autoshkollave janë përgjithësisht në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Parregullsi janë vënë re në mungesa autorizimi të instruktorëve të praktikës, mungesë kontrate të këtyre instruktorëve me autoshkollën.

Janë evidentuar raste kur në procestin e praktikës numri i kandidatëve për drejtues mjeti ishte më shumë se dy. Janë monitoruar në periudha të ndryshme ditore testimet e kandidatëve për drejtues mjeti mbi normat e sjelljes në praktikë duke u konstatuar se autoshkollat nuk respektojnë planifikimin paraprak të numrit të pjesëmarrjes të kandidatëve për testim me atë faktik, duke bërë që komisionet të mos realizojnë testimin e numrit të kandidatëve të planifikuar.

## **2. Sektori i drejtuesve të mjeteve**

Objekt kontrolli i këtij sektori është:

- Zbatimi i akteve ligjore e nënligjore, rregulloreve, urdhërave dhe shkresave të Drejtorit të Përgjithshëm;
- Administrimi i dokumentacionit të qytetarit dhe zbatimi i procedurave për pajisje me lejedrejtimi për herë të parë ose për shtesë kategorie, rinovimi i lejedrejtimeve, konvertimi i lejedrejtimit nga e huaj në Shqiptare;
- Aplikimi elektronik për pajisje me lejedrejtimi;
- Pajisja me lejedrejtimi ndërkombëtare;
- Lëshimin e vërtetimeve për lejedrejtimi;
- Komunikimi dhe sjellja me qytetarin.



Nga sektori i drejtuesve të mjeteve janë kryer kontrolle në Drejtoritë Rajonale Tiranë, Kukës dhe Durrës.

Nga kontrollet janë konstatuar probleme:

- në korigjimin e gabimeve materiale, procedurë kjo në përputhje me Udhëzimin Nr. 2 datë 2.3.2009 "Për procedurat, kriteret dhe kompetencat për korigjimin e pasaktësive dhe gabimeve të dukshme të aktit në dokumentet e drejtuesve të automjeteve";
- Në inventarizimin e dosjeve, të përcjella nga sportelet e shërbimit në arkivë, etj.

### 3. Sektori i Arkivave të lejeve të drejtimit

Objekt kontrolli i këtij sektori është:

- Zbatimi i akteve ligjore e nënligjore, rregulloreve, urdhërave dhe shkresave të Drejtorit të Përgjithshëm;
- Administrimi dhe hedhja e të dhënave në regjistra;
- Marrja në dorëzim e dosjeve, nëndosjeve dhe fashikujve nga punonjësi i arkivës dhe sistemimi i tyre në dosar;
- Plotësimi i vërtetimeve të lejedrejtimit.

Gjatë vitit 2015 në arkivën kombëtare të lejedrejtimit janë verifikuar dhe konfirmuar 1200 lejedrejtimi sipas kërkesa me email të drejtorive rajonale.

Janë verifikuar rreth 4000 lejedrejtimi për konvertim nga shqiptare në të huaja dhe anasjelltas.

Ka vazhduar rregullisht korespondenca me prokurorinë, gjykatën dhe policinë e shtetit.

Gjatë këtij viti janë zhvilluar kontrolle në disa arkiva në drejtoritë rajonale, ku janë konstatuar problematika në lidhje me administrimin e dokumentacionit në to, për të cilat po punohet dhe me sektorin e lejedrejtimit për eliminimin e këtyre problemeve.

Në këto arkiva është konstatuar mungesa e hapësirave për sistemimin dhe ruajtjen e dosarëve në to.

Gjithashtu dhe në arkivin qendror mungon hapësira për sistemimin e regjistrave.

### IV. PROBLEME TË KONSTATUARA DHE MASAT QË JANË MARRË

1. Janë konstatuar 4 raste që autoshkolla nuk plotëson kërkesat e Udhëzimit Nr.994, datë 12.3.2003, i ndryshua. Masat që janë marrë - Brenda muajit të rregullojnë ambientet ose të ndryshojnë ambientet duke plotësuar kushtet. Këto detyra janë lënë Degës së Drejtuesve të mjeteve
2. Janë konstatuar 3 raste që mjefi i autoshkollës nuk plotëson kërkesat teknike. Masat që janë marrë - brenda muajit të zëvendësohen me mjete duke plotësuar kushtet teknike sipas VKM-së Nr. 543, datë 13.6.2013;



3. Është konstatuar se në Drejtorinë Rajonale Tiranë, nga autoshkollat, nuk respektohet zbatimi i grafikut të teorisë dhe praktikës, problem i cili kërkon zgjidhje në vazhdimësi;
  4. Janë evidentuar 14 raste të cilësisë së dobët të fotografisë së aplikantit, 8 raste në Durrës dhe 6 raste në Vlorë. Janë ripërsëritur fotot dhe janë marrë masa për rregullimin e ambientit të marrjes së fotos. Është dërguar shkresë të gjithë DR për të marrë masa. Njëkohësisht është përmirësuar sistemi informatik e-form për ritjen e cilësisë së fotos;
  5. Janë konstatuar 10 raste anulim aplikimesh në prodhim (DR Tiranë Durrës, Kukës dhe Berat). Është bërë riaplikim, njëkohësisht janë njoftuar të gjithë Drejtoritë Rajonale mbi mosnjohjen e skarciteteve të bëra për shkak të gabimeve materiale në aplikim;
  6. Në DRSHTRR Tiranë ka patur raste vonesash në shërbimin e qytetarëve. Kjo dhe për faktin e ambienteve. Me përfundimin e ndërtesës së re shërbimi ndaj qytetarëve do të rritet ndjeshëm;
  7. Janë 190 raste vonesash për konvertimin e lejedrejtimit Greke në Shqiptare, duke filluar nga viti 2008. Nga ana jonë i është bërë kërkesë MPJ, por akoma problem nuk ka gjetur zgjidhje;
  8. Ka patur probleme në tërheqjen e lejeve të drejtimit nga qytetarët. Me krijimin e sistemit informatik tërheqja e lejeve të drejtimit bëhet nëpërmjet nënshkrimit elektronik;
  9. Janë konstatuar 6 raste gabimesh në korigjimin e dosjeve të drejtuesve të mjeteve që kanë gabime material (4 raste në DR Durrës dhe 2 raste në DR Kukës)
  10. Në 2 Drejtori Rajonale janë konstatuar probleme në plotësimin e regjistrave të arkivës. Është përgatitur rregullorja ku caktohen regjistrat që duhet të plotësojë arkivisti;
  11. Janë konstatuar rreth 15 raste vonesash në transferimin e dosjeve, sidomos DR Shkodër, Durrës, Korçë. Janë këshilluar dhe është marrë masë nga ana e tyre.
- Të gjitha problemet e konstatuara më sipër janë trajtuar në Drejtorinë Rajonale përkatëse, në analizën vjetore, ku dhe kanë marrë zgjidhje.

## V. OBJEKTIVA PËR VITIN 2016

1. Me daljen e Udhëzimit të ri "Për aktivitetin e autoshkollave ..." do të bëhet program i ri informatik për modelin e ri të lejedrejtimit, i cili do të ketë përputhshmëri me Direktivën 2006/126/ BE.

Në këtë Udhëzim përcaktohen kategoritë e lejedrejtimit të mjeteve, mënyra e kalimit nga një kategori lejedrejtimi në një tjetër, programet e përgatitjes teorike dhe praktike, kohëzgjatja e nevojshme, provimet për marrjen e lejedrejtimeve, gabimet e lejuara, programet e kualifikimit të mësuesve të teorisë dhe instruktorëve të praktikës. Të gjitha këto masa synojnë në rritjen e standarteve të përgatitjes së drejtuesve të mjeteve.



2. Do të kërkojmë MPJ krijimin e mundësisë të një takimi midis dy drejtorive përkatëse të lejeve të drejtimit për zgjidhjen sa më të shpejtë të problemit të vonësave të konvertimit me palën Greke;
3. Në zbatim të Kodit Rrugor, neni 117, pika 9 do të kërkojmë pranë MTI ngritjen e komitetit të posaçëm teknik, i cili do të përcaktojë rregullat për komisionet mjekësore vendore për plotësimin e kodeve të harmonizuara, për drejtuesit e mjeteve dhe për mjetet;
4. Do të kërkojmë bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes civile për ta na mundësuar listën e personave që kanë humbur jetën. Kjo bën të mundur evidentimin e tyre në regjistrin kombëtar të lejeve të drejtimit e si rrjedhim sisteminin e dosjeve në arkivë;
5. Nxjerrje rregullash dhe rritje e kërkesës së llogarisë ndaj komisionerëve të marrjes në prova të teorisë dhe praktikës me qëllimin e vetëm LEJEDREJTIMI E MERITUAR;
6. Me përfundimin e godinës së re në Drejtorinë Rajonale Tiranë do të përmirësohet ndjeshëm cilësia e shërbimit, si rezultat i krijimit të një sale të re për trajnime, provime teorie dhe për dëshmitë profesionale. Përmirësime do të bëhen dhe në Drejtoritë të tjera Rajonale si në Elbasan, Durrës etj.;
7. Do të unifikohen të gjithë regjistrat në përdorim në 13 drejtorite rajonale duke bërë dhe rregulloren përkatëse.

### **Mbi punën e Drejtorisë së Kualifikimeve Profesionale**

Gjatë vitit 2015, në përmbushje të Programit Vjetor të Punës të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, puna e Drejtorisë së Kualifikimeve Profesionale dhe e sektorëve në varësi të saj, ka qenë e përqendruar dhe ka funksionuar në keto drejtime:

#### **I.Në punën për përmirësimin dhe vënien në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e kualifikimeve profesionale dhe konkretisht;**

I.1.Në plotësim të detyrimeve që rrjedhin nga neni 115/1 i Ligjit Nr.8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimi i MTI, Nr. 3606/2, datë 28.10.2011 "Për pajisjen e përdoruesve të mjeteve rrugore të kategorive C, CE, D dhe DE, me Çertifikatën e Afësisë Profesionale(ÇAP)", i ndryshuar, dhe në përputhje me direktiven BE 2003/59/CE, datë 15.07.2003, specialistet e Drejtorisë së Kualifikimeve Profesionale;

- a. në plotësim të detyrimeve të Urdhërit Nr.1041, datë 23.12.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm, punuan me seriozitet për hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit për tenderin me objekt "Sistemi i regjistrimit, testimit elektronik, aplikimit për karton për CAP dhe dëshmi



Taksisti, si dhe dizenjim, prodhim, personalizim i kartës dhe mirëmbajtje e sistemit”.

b.ndoqëm me korrektësi realizimin e kontratës Nr. Nr.10106, datë 24.07.2015, me objekt “Sistemi i regjistrimit, testimit elektronik, aplikimit për karton për CAP dhe dëshmi Taksisti, si dhe dizenjim, prodhim, personalizim i kartës dhe mirëmbajtje e sistemit” të lidhur ndërmjet DPSHTRR-së dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “ADVANCE BUSINESS SOLUTIONS-ABA” shpk & “Cetis” Graphic & “Documentation Service d.d”.

Realizimi me sukses i këtij projekti, krijoi mundësinë e fillimit të procedurave për vënien në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Transporteve, Nr. 3606/2, datë 28.10.2011 “Për pajisjen e përdoruesve të mjeteve rrugore të kategorive C, CE, D dhe DE, me Çertifikatën e Aftësisë Profesionale(ÇAP)” i ndryshuar.

Nisur nga përvoja e vendeve të BE, që kur hartuam specifikimet teknike me miratimin e MTI, parashikuam dhe vendosëm që modeli i CAP, që do të lëshohej nga ne, të ishte njëri nga modelet e parashikuara nga ky udhëzim dhe konkretisht ai i **Kartës prej polikarbonati**, me karakteristika fizike që përcaktojnë shtandartet ISO 7810 dhe 7816-1, me element sigurie në përputhje me Direktivën 2006/126 KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të datës 20.12.2006.

#### **1.2.Hartuam dhe miratuam:**

- a. Rregulloren Nr.6, datë 09/12/2015 “Mbi procedurat e regjistrimit, testimit dhe pajisjes së aplikantëve me Dëshmi Taksisti” si dhe “Manualin e Përdorimit” të programit elektronik përkatës
- b. Rregulloren Nr.7, datë 11/12/2015 “Për administrimin e aktivitetit të kualifikimit dhe testimit të kandidatëve të cilët do të pajisen me Certifikatën e Aftësisë Profesionale (CAP), si dhe “Manualin e Përdorimit” të programit elektronik përkatës
- c. Hartuam dhe miratuam pyetsorin teorik të përbërë prej rreth 3600 pyetje të sistemuara në 440 problematika bazë i cili do të shërbejë për kontrollin kompjuterik të njohurive të fituara nga aplikantët gjatë kurseve të trajnimit periodik.

**1.3. I kërkuam MTI, shfuqizimin e gjurmës d të nenit 7 të Udhëzimit Nr.1, date 28.01.2009 “Për pajisjen me Certifikatën e Kompetencës Profesionale të Drejtuesit të Veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor”, për tu përshtatur me shtesat e pikave 6.5 dhe 6.6 të bëra në VKM Nr.194, date 09.03.2011, në Rregulloren “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave**



dhe udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumentave zyrtarë, të caktuara për këta operator”.

**Për këtë:**

- a. i propozuam MTI, nevojën për riformulimin e nenit 7/1 të këtij udhëzimi, të cilat u materializuan me Udhëzimin Nr.5, date 27.05.2015”Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr.1, date 28.01.2009 “Për pajisjen me Certifikatën e Kompetencës Profesionale të drejtuesit teknik ”
- b. hartuam programin teorik të reduktuar për trajnimin e drejtuesve teknik të operatorit të transportit rrugor që do të kërkojnë rinovimin e Certifikatën e Kompetencës Profesionale, i cili u miratua nga Ministri me shkresën Nr.3371/1, date 25.06.201115.
- c. Hartuam rregulloren Nr.5, date 15.07.2015 “Për procedurat e regjistrimit, trajnimit dhe pajisjes së aplikantëve për Drejtues Teknik të Operatorit të transportit Rrugor, me Certifikatën e Kompetencës Profesionale CKP”

**II.Në kualifikimin, testimit dhe pajisjen e punonjësve të të gjitha sektorëve të shërbimit të DRSHTRR-së me Çerifikatat përkatëse të Trajnimit Aftësimi Profesional.**  
**Për këtë:**

**II.1.Në muajin Mars dhe Prill, në bashkpunim me Drejtorinë e Drejtuesve të Mjeteve dhe Drejtorinë e Administrimit dhe Teknologjisë të Informacionit, sipas një programi të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, organizuam dhe zhvilluam, kurset e trajnimit me të gjithë punonjësit e Drejtorive Rajonale të profesionit inxhjer mekanik, “Për procedurat e shërbimit në Sektorin e lejedrejtimit”,**

**II.2.Gjatë muajit Tetor, në bashkpunim me Drejtorinë e Regjistrimit, Liçensimit dhe Çertifikimit të Mjeteve Rrugore dhe Drejtorinë e Administrimit dhe Teknologjisë të Informacionit, sipas një programi të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, organizuam dhe zhvilluam:**

- a. trajnimit me të gjithë punonjësit e Drejtorive Rajonale që punojnë në sektorin e regjistrimit të mjeteve,
- b. ritrajnimit të punonjësve të Kontrollit Fizik, të Kontrollit të Tahogرافit dhe të arshivave të mjeteve rrugore, të DRSHTRR-ve,
- c.trajnimi i punonjësve të Sektorit të Lejeve të Drejtimit të Drejtorive Rajonale që kryejn shërbimin e regjistrimit për herë të parë, testimin dhe pajisjen e aplikantëve me Dëshmi Taksisti, dhe CAP, apo që kryejn rinovimin për arsye të kalimit të afatit të vlefshmërisë apo për demtim, hjumbje apo vjedhje të tyre.



Këto kurse kishin si qëllim përfitim të njohurive të plota teknike dhe ligjore në plotësimin e detyrave në shërbimet që lidhen me regjistrimin e mjeteve apo edhe drejtuesve të tyre, si dhe pajisjen e punonjësve përkatës me të gjitha aktet ligjore dhe nenligjore që rregullojnë këtë aktivitet.

**III. Në ndjekjen dhe realizimin e procedurave të kualifikimit dhe testimit të apikantëve që kërkojnë të pajisen me certifikata apo dëshmi të aftësisë profesionale dhe konkretisht:**

**III.1. Në plotësim të detyrimeve të Ligjit nr.9272, datë 16.09.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëshjen Europjane, për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR) dhe Ligjit Nr.118, datë 13.12.2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, ka mundur:**

**a. trajnimin e 140 drejtuesve të mjeteve që kanë kërkuar rifreskimin e njohurive për rinovimin e Certifikatës ADR,**

**b. trajnimin për njohurit bazë dhe speciale ADR, për rreth 260 drejtues mjeteve që kanë kërkuar të pajisen me certifikatën e trajnimit ADR, për herë të parë.**

**c. pajisjen me Certifikatë Trajnimi ADR për herë të parë, të 259 drejtuesve të mjeteve nga 211 të pajisur me këtë certifikatë në vitin 2014,**

**d. pajisjen me Certifikatën e Trajnimit ADR, të rinovuar, të 110 drejtuesve të mjeteve, nga 152 të pajisur në vitin 2014,**

**III.2. Në plotësim të detyrimeve të VKM nr.706, datë 01.07.2009 “Për pajisjen e manovratorëve të makinerive të rënda me Dëshminë e Aftësisë Profesionale”, dhe Rregullores Nr.2, datë 09.08.2013 “Për Kushtet, Kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmise së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me Urdhërin Nr.109, datë 05.08.2013, datë 2013 të Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Drejtoria e Kualifikimeve Profesionale ka pajisur me Dëshminë e Aftësisë Profesionale(DAP):**

**a. Automekanicist, për përdorimin e makinerive të rënda për punime ndërtimi me bazë automjetin, 538 aplikantë nga 243 aplikantë të pajisur në vitin 2014,**

**b. Ekskavatoristë me goma dhe zinxhirë, për përdorimin e të gjitha tipeve të mjeteve të rënda për punime ndërtimi dhe toke, gërmimi dhe ngarkimi dherash, të llojit ekskavator me rrota gome, apo me zinxhirë 477 aplikantë, nga 400 aplikantë të pajisur në vitin 2014,**



c.**Buldozeristë**, për përdorimin e të gjitha tipeve të mjeteve të rënda për punime ndërtimi dhe toke, gërmimi, nivelimi dhe spostimi të dherave, të llojit Buldozer me goma ose me zinxhirë, **31 aplikantë**, nga 24 të pajisur në vitin 2014

e.**Janë rinovuar**, për kalimin e afateve të vlefshmërisë, dëmtim, humbje etj, **176 DAP**(dëshmi të aftësisë profesionale) të llojeve të ndryshme, nga 116 DAP të rinovuar në vitin 2014,.

Rritja e numrit të dëshmive apo certifikatave të trajnimit apo aftësisë profesionale të lëshuara nga ne gjatë vitit 2015, është frut i bashkrendimit dhe bashpunimit të sukseshëm të Drejtorisë sonë me Drejtorinë e Kontrollit në Rrugë kontributi i të cilës vlen për tu lavdëruar edhe në këtë analizë.

Po kështu, përsa i përket rritjes në veçanti të numrit të aplikantëve që janë pajisur me Dëshminë e Aftësisë Profesionale DAP, për përdorimin e mjeteve të rënda për punime ndërtimi dhe toke, kontribut të veçantë ka edhe Inspektoriati Shtetëror i Punës, bashkpunimi me të cilin do vazhdoi edhe gjatë vitit 2016.

**III.3.Në plotësimin e kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.325, datë 19.03.2008** “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve si dhe për dokumentacionit zyrtar të caktuar për këta operator”, dhe akteve nenligjore në zbatim të tij, është mundësuar:

a.trajnimi për herë të parë i 18 aplikantëve dhe janë lëshuar 66 CKP për Drejtues Teknik të operatorit të transportit rrugor.

b.trajnimi për rinovimin e njohurive i 75 aplikantëve dhe janë lëshuar 289 Certifikata të Kompetencës Profesionale CKP të rinovuara.

**III.4.Në plotësim të nenit 121 të Ligjit Nr.8378, datë 22.07.1998** “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe akteve në zbatim, janë pajisur me;

a.Dëshmi të Aftësisë Profesionale Mësues Teorie në Autoshkolla, pasi janë shpallur fitues në provimet përkatëse, 22 kandidatë

b. Dëshmi të Aftësisë Profesionale Instruktor Praktike në Autoshkolla 109 kandidatë, pas shpalljes fitues të testimit përkatës të organizuar nga DPSHTRR-ja.

c.janë rinovuar 261 Dëshmi të Aftësisë Profesionale për Instruktor Praktike, pas përfundimit të afateve kohore të vlefshmërisë dhe 72 për Mësues të Teorisë në Autoshkolla



IV. Për vitin 2016 Drejtoria e Kualifikimeve Profesionale ka si objektiva:

- IV.1. Përmirësimin cilësor të metodologjisë së trajnimeve profesionale nëpërmjet përmirësimit të nivelit të materialeve referuese, duke pasqyruar në to të gjitha ndryshimet e bëra në aktet ligjore dhe në ligjore dhe në Direktivat e Komunitetit Europian.
- IV.2. Informatizimin e procedurave të regjistrimit, trajnimit, testimit dhe pajisjes së aplikantëve që do të kërkojnë të pajisen me certifikatë Trajnimit ADR.
- IV.3. Fillimin e procedurave për regjistrimin, trajnimin, testimin dhe pajisjen e aplikantëve që do të kërkojnë të bëhen Përgjegjës Teknik të veprimtarisë së autoriparimit dhe Titullar të axhensive të praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe rimorkiove të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9573, datë 03.07.2007, "Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtarite që lidhen me to".

**Drejtoria e Administrimit dhe Teknologjisë së Informacionit**

Është pjesë përbërëse e Strukturës së DPSHTRR-së dhe menaxhon, mirëmban dhe zhvillon sisteme të Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit për të plotësuar nevojat e institucionit DPSHTRR-së në qendër dhe në Drejtoritë Rajonale. Në mbështetje të Drejtorive të tjera pjesë përbërëse e strukturës së DPSHTRR-së parashikon zhvillime të reja në fushën e teknologjisë së informacionit dhe nevojat e institucionit. Sipas strukturës, ajo është e organizuar në tre sektorë:

- SEKTORI I ADMINISTRIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË PROGRAMEVE
- SEKTORI I INFRASTRUKTURËS DHE PAJISJEVE INFORMATIKE
- SEKTORI I RRJETIT DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Në lidhje me punën e kryer në vitin kalendarik 2015 ju pasqyrojmë një përmbledhje të aktivitetit të kësaj drejtorie.

- Në bashkëpunim me specialistët e Drejtorisë së Lejeve të Drejtimit, në fillim të vitit 2015, kanë implementuar në DPSHTRR dhe 13 Drejtorite Rajonale projektin "Formulari elektronik për prodhimin e lejeve të drejtimit".
- Në bashkëpunim me specialistët e Drejtorisë së Lejeve të Drejtimit, në prill të vitit 2015, kanë implementuar në DPSHTRR dhe 13 Drejtoritë Rajonale sistemin "Lejedrejtimi me pikë". Gjithashtu në bashkëpunim me AKSHI është realizuar ofrimi i shërbimit "Pikët e drejtuesit të njetit", në portalin qeveritar e-albania.



- Është realizuar instalimi i 13 serverave të rinj të testimit në 13 Drejtoritë Rajonale.
- Është realizuar instalimi i pajisjeve të fotografimit para testimit teorik në 13 Drejtoritë Rajonale.
- Në bashkëpunim me specialistët e Drejtorisë së Kualifikimeve Profesionale gjatë vitit 2015 janë ndjekur detyrimet e kontratës së shërbimit Nr 10106, datë 24.07.2015 me objekt *"Sistemi i regjistrimit, testimit elektronik, aplikimit për karton për CAP dhe dëshmi taksisti, si dhe dizënim, prodhim, personalizim i kartës dhe mirëmbajtje e sistemit"*, dhe kanë implementuar në DPSHTRR dhe 13 Drejtoritë Rajonale këtë projekt.
- Gjatë vitit 2015 specialistët e kësaj drejtorie kanë ndjekur dhe zbatuar detyrimet e kontratave të shërbimit:
  - Nr.16749 datë 31.12.2012, me objekt *"Mirëmbajtja e Sistemit të Ri Informatik dhe Server Room të DPSHTRR-së"*;
  - Nr. 16752, datë 31.12.2012 me objekt *"Automatizimi i procesit të pajisjes me Leje Drejtimi- Mirëmbajtja"*.
  - Nr. 16752, datë 31.12.2012 me objekt *"Automatizimi i procesit të pajisjes me Leje Drejtimi- Mirëmbajtja"*.
  - Nr. 9558, datë 18.07.2012 me objekt *"Shërbimi i transmetimit të të dhënave"*
- Janë ndjekur dhe zgjidhur kërkesat e Drejtorive Rajonale për të gjitha problematikat që kanë lidhje me aplikimet informatike të implementuara në DPSHTRR dhe DR.Rajonale
  - ❖ Programi informatik i regjistrimit të mjeteve;
  - ❖ Programi informatik i gjobave të kontrollit rrugor;
  - ❖ Programi informatik i taksës vjetore të mjeteve të përdorura;
  - ❖ Programi informatik i regjistrimit dhe testimit automatik të kandidateve për leje drejtimi;
  - ❖ Programi informatik i formularit elektronik për prodhimin e lejeve të drejtimit;
  - ❖ Programi informatik i lejedrejtimit me pikë;
  - ❖ Programi informatik i dëshmisë së taksistit;
  - ❖ Programi informatik i aplikimit për CAP;
- Është punuar për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrjetit dhe pajisjeve informatike në Drejtorinë e Përgjithshme si edhe nëpër Drejtoritë Rajonale.



- Specialistë të sektorit të rrjetit dhe sigurisë së të dhënave kanë marrë pjesë në hartimin e termave të referencës dhe ndjekjen e hartimit të projekteve për rikonstruksionin e zyrave në DRSHTRR Durrës, DRSHTRR Vlorë dhe DRSHTRR Gjirokastrë.
- Është reailizuar transferimi i DRSHTRR Berat në ambjentet e reja, ku është reailizuar rivendosja e të gjithë posteve të punës.
- Është reailizuar transferimi i pjesshëm i Degës së Lejeve të Drejtimit të DRSHTRR Tiranë në ambjentet e NSHRAK, ku është reailizuar rivendosja e të gjithë posteve të punës.
- Është ndjekur realizimi i investimit të rikonstruksionit të zyrës së taksave në NSHRAK.
- Është punuar në mënyrë të vazhdueshme për të parandaluar dhe evidentuar të gjitha difektet e mundshme që vijnë si rezultat i luhatjes së tensionit, shkarkesave elektrike apo goditjeve fizike.
- Është kryer zëvendësimi, riparimi, konfigurimi i pajisjeve të rrjetit si router, switch në të gjithë infrastrukturën e rrjetit të DRSHTRR-së.
- Është kryer zëvendësimi, riparimi, konfigurimi i pajisjeve kompjuterike si kompjutera, printerat etj në të gjithë infrastrukturën e DRSHTRR-së.
- Është ndjekur procedura e mirëmbajtjes së adresave zyrtare të DRSHTRR-së për drejtorinë, sektorët, punonjësit etj.
- Janë hartuar specifikimet teknike për procedura të ndryshme tenderimi si dhe janë hartuar certifikatat e pranimit të tyre:
  - ❖ Blerje Pajisje Informatike për përdorim para testimit teorik të kandidatëve për drejtues mjeti;
  - ❖ Blerje e formularë dhe prokatë të Lejeve të Drejtimit.
  - ❖ Blerje bojëra printeri
- Është bërë dizajni grafik i:
  - ❖ Pulla "Taksa Vjetore e Mjeteve të Përdorura 2016" me elementet grafike dhe të sigurisë.
  - ❖ Kartave të identifikimit të punonjësve të drejtorive rajonale.



- Janë mbyllur në kohë procedurat e shkëmbimit të informacionit shkresor me të gjithë institucionet.

## **ANALIZA**

### **MBI AKTIVITETIN E DREJTORISË PËR ADMINISTRATËN DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE PËR VITIN 2015**

Drejtoria për Administratën dhe Shërbimet Meshtetese është riorganizuar si strukture pas miratimit nga ministri përgjegjës për transportin, me shkresë nr 2469/1 datë 25.06.2014, me qëllimin kryesor bashkërendimin sa më të mirë të punës dhe detyrave për të pesë sektoret që ajo mbulon,

- ❖ Sektori i Burimeve Njerezore,
- ❖ Sektori Juridik,
- ❖ Sektori i Prokurimeve,
- ❖ Sektori i Informacionit,
- ❖ Sektori i Shërbimeve Mbështetëse

Kjo drejtori ka funksionuar si pjesë organike e Drejtorisë së Përgjithshme dhe njëkohesisht ka mbajtur marrëdhënie të afërta pune me të gjitha Drejtoritë e tjera pranë DPSHTRR-së si dhe me Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

#### **1. SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE**

Në kuader të përpjekjeve për të siguruar një performancë sa më të lartë si institucion, si edhe bazuar në Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nën 21, të Ligjit Nr 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës", i ndryshuar, si edhe mbështetur në akte të tjera ligjore e nënligjore që veprojnë në R.SH dhe SBNJ jep kontributin e tij.

Gjatë këtij viti në qendër të vëmendjes tone ka qenë puna dhe përfaqësimi sa më i denjë i punonjësve dhe punës së tyre. Në këtë kuader, SBNJ, si pjesë përberëse e Drejtorisë për Administratën dhe Shërbimet Mbështetëse ka bashkëpunuar me strukturat e tjera të DPSHTRR për arritjen e rezultateve të synuara.

Në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe DATI, dhe me propozimet e Drejtorve Rajonale, janë identifikuar punonjësit që janë bërë pengesë për shërbimin në kohë dhe me qëllim ndaj qytetarëve lidhur me problemin e hedhjes dhe pasqyrimin të taksave në sistem



apo ofrimit të shërbimeve dhe janë marrë masat administrative përkatëse, për punonjësit përgjegjës.

Në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale janë përlogaritur afatet e njoftimit të punonjësit me të cilin DPSHTRR ka ndërprerë marrëdhëniet e punës.

Gjatë vitit 2015 është punuar në kuadër të përmirësimit të punës dhe në Sektorin e Burimeve Njerezore. Kështu edhe gjatë këtij viti nevojat e institucionit si në Drejtorinë e Regjistrimit të Mjeteve, Liçensimit, Çertifikimit ashtu dhe në Drejtorinë e Drejtuesve të Mjeteve dhe degët e tyre në Drejtoritë Rajonale, u realizua duke punësuar punonjës provizorë, për të cilët u lidhën kontratat provizore me afat 3 muaj duke u bërë edhe shtyrjet e kontratave sipas identifikimit të nevojave nga Drejtoritë Rajonale.

Në vazhdimësi janë ndjekur dhe nevojat për punonjës të rinj në mbështetje të kërkesave të bëra nga Drejtoritë Rajonale duke bërë edhe shtesat përkatëse, sipas Drejtorive.

Në bazë të VKM Nr. 478, datë 16.06.2010 "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie" si edhe ndryshimet me të fundit që e kanë përmirësuar këtë kuadër ligjor, u është kërkuar Drejtorive Rajonale të bëjnë përlogaritjet për kohën e daljes në pension pleqërie të punonjësve në organet e çdo drejtorie dhe të njoftojnë punonjësit që plotësojnë kushtet për pension pleqërie gjatë kësaj periudhe, për datën e daljes së tyre në pension me qëllim që të bëjnë përgatitjet e nevojshme të dokumentacionit përkatës për të përfituar në kohë nga e drejta për pension.

Në bazë të kërkesave të punonjësve janë pajisur me vërtetime pune apo pagë sipas çdo kërkesë.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Ekonomike, për çdo emerim apo largim është njoftuar Drejtoria e Tatimeve brenda afateve ligjore.

Për çdo fillim muaji është përpiluar listë-prczenca e punonjësve për muajin e kaluar duke bërë rakordimet me nëpunësin e shërbimit si edhe janë ushtruar kontrolle për verifikimin e zbatimit të orarit të punës.

Për çdo shkresë të ardhur në DPSHTRR, lidhur me objektin e punës së SBNJ, është përgatitur përgjigjja përkatëse për derguesin (qoftë ky individ, institucion shtetëror apo privat) brenda afateve ligjore të parashikuara.

Në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, Sektori i Financës është përlogaritur për efekt pagese vjetërsia e punonjësve.

Protokolli dhe Arkiva kanë patur dhe përballuar një punë voluminoze. Për vitin 2015, janë protokolluar, shpërdarë dhe përgatitur për postë përkatësisht



- Shkresa te jashtme 18564 shkresa
- Shkresa te brendshme 2125 shkresa
- Urdhra 937 (nga te cilat 529 te SBNJ)
- Vendime 220 (nga te cilat 201 te SBNJ)

Drejtorive Rajonale u eshte terhequr vemendja lidhur me rregullat e protokollimit dhe manaxhimit te shkresave, u eshte kerkuar te bejne nje organizim sa me te mire lidhur me pushimet vjctore te pagueshme te punonjesve te tyre dhe koordinimin e punonjesve qe nderpresin marredheniet e punes, per te organizuar punen me qellim mospengimin e aktivitetit te cdo drejtorie, por edhe ofrimin ne kohe e me cilesi te sherbimeve per qytetaret. Per kete arsye, jane perpiluar edhe Udhurat per kryerje te detyrave ne zevendesim te perkohshem te punonjesve qe mungonin per arsye objektive (leje zakonshme, raporte mjekesore etj)

Eshte punuar ne drejtim te permiresimit te vazhdueshem te skedarit te dosjeve personale te punonjesve dhe pasurimit te tyre. Sistemimi i tyre, i organizuar ne rend alfabetik ka ndihmuar ne nje manaxhim me te lehte dhe eshte kerkuar dhe realizuar nga te gjitha Drejtorite Rajonale pasurimi i tyre.

Bazuar ne kontrollat e brendshme te kryera nga ana e Drejtorise se Auditit te Brendshem dhe Drejtorive operative, per te gjitha rastet kur jane verejtur shkelje te akteve ligjore e nenligjore jane zbatuar sanksionet administrative per punonjesit pergjegjes, ne respektim me procedurat qe parashikon Kodi i Punes. Keshtu, jane evaduar masat e propozuara dhe miratuara ne Memorandumet e pergatitura nga Drejtoria e Auditimit te Brendshem prane DPSHTRR-se.

Struktura e Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor ka ndryshuar me miratimin e MTI dhe ne unison me kete ndryshim eshte pergatitur dhe miratuar nga Keshilli Drejtues i DPSHTRR-se edhe struktura e re e Drejtorive Rajonale

Nga Drejtorite Rajonale priten ne vazhdimesi kontratat e punes per punonjesit e emeruar rishtas.

Problem ne vazhdimesi eshte papergjegjshmيريا e Drejtorive Rajonale per te njoftuar prane DPSHTRR per problem apo problematika qe kane te bejne me menaxhimin e burimeve njerezore prane ketyre drejtorive. Kjo vihet re si ne njoftimin e punonjesve qe jane me raporte mjekesore per paaftesi te perkoheshme ne punë, ashtu edhe probleme te tjera dhe ketu behet fjale sidomos per punemarresit me te cilet DPSHTRR ka filluar procedurat per nderprerje te marredhenieve te punes, duke sjelle jo pak here edhe problematika ne procese gjyqesore.



## 2. SEKTORI JURIDIK,

Gjatë vitit 2015 Sektori Juridik ka ushtruar kompetencat e përcaktuara në aktet e brendshme, si një strukturë mbështetëse, ku fokusi i punës ka qenë mbështetja ligjore e gjithë veprimtarisë dhe aktivitetit të DPSHTRR, kontrolli i zbatimit të legjislacionit, dhënia e mendimit të specializuar juridik në lidhje me hartimin e projekt- akteve ligjore, nënligjore dhe administrative, rishikimin dhe përmirësimin e tyre.

Në bashkërendim të punës me drejtoritë dhe sektorët e tjerë të institucionit ka dhënë ndihmën juridike për hartimin/ndryshimin e marrëveshjeve bashkëpunuese me institucionet e tjera, për hartimin/ndryshimin e akteve nënligjore, për hartimin/ndryshimin e projekt-rregulloreve të ndryshme që rregullojnë funksionimin e brendshëm të drejtorisë, zgjidhje të problematikave të ndryshme me natyrë juridike drejtuar nga sektorë të ndryshëm brenda drejtorisë si nga Drejtoria Ekonomike apo Drejtoria e Regjistrimit dhe Licensimit të Mjeteve, Drejtoria e kualifikimeve profesionale si dhe Drejtoria e drejtuesve të mjeteve.

Gjithashtu ka dhënë konsulencën dhe ndihmën e nevojshme për një sërë çështjesh apo problematika, drejtuar nga drejtoritë rajonale si:

- Problematika lidhur me pronësinë e automjeteve.
- Problematika lidhur me regjistrimin e automjeteve.
- Problematika lidhur me detyrimet monetare të individëve, personave fizik apo juridike ndaj DPSHTRR.
- Problematika lidhur me shërbimet ndaj shoqërive përmbarimore.....etj

Në funksion të veprimtarisë, lidhur me çështjet gjyqësore, sektori juridik ka ndjekur dhe përfaqësuar në organet gjyqësore të gjitha çështjet gjyqësore ku DPSHTRR ka qenë si palë ndërgjyqëse.

Nisur nga natyra e çështjeve, theksojmë që larmishmëria e objekteve të shqyrtuara ka qenë e natyrave të ndryshme por shumica e tyre kanë patur për objekt gjykimin marrëdhëniet e punës dhe detyrimet kontraktore për kontrata në fushën e prokurimit publik.

Në disa çështje (me objekt marrëdhëniet e punës) gjykata ka vendosur të shprehet pjesërisht në favor të DPSHTRR kurse disa çështje (me objekt detyrimet kontraktore) kanë përfunduar në favor të DPSHTRR.

Të gjitha çështjet e përfunduara në shkallën e parë të gjyqësorit janë apeluar në Gjykatën e Apelit.

Gjithashtu dhe në gjykatën e Apelit janë zhvilluar një sërë çështjes gjyqësore të cilat përgjithësisht janë mbyllur duke lënë në fuqi Vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë. Sektori Juridik për çdo rast të vendosur ka vazhduar procedurat e mëtejshme ligjore duke bërë edhe rekurs në Gjykatën e Lartë.



Theksojmë që përfundimi i shumicës së çështjeve gjyqësore me objekt mardhëniet e punës në favor të DPSHTRR ka ardhur si rezultat i zbatimit të pirocëdurës për zgjidhjen e rregullit të një kontrate pune.

Një risi tjetër e arritur në bashkëpunim edhe me drejtorinë ekonomike pranë DPSHTRR është mënyra vullnetare e ekzekutimit të detyrimeve të lindura nga vendimet gjyqësore. Në këtë mënyrë arritën të ulen sadopak shpenzimet në lidhje me këto vendime, duke qënë që edhe numri i çështjeve gjyqësore të cilat priten të mbarojnë është relativisht i madh.

Në punën tonë jemi munduar të zbatojmë me përpikmëri të gjitha detyrat funksionale dhe ligjore.

Veprimtaria e sektorit do të vazhdojë të jetë e fokusuar në drejtim të mbështetjes ligjore në lidhje me veprimtarinë e DPSHTRR nëpërmjet;

- ❖ përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave të institucionit në çështjet gjyqësore në të tre shkallët e gjykimit, ku DPSHTRR është palë ndërgjyqëse.
- ❖ dhënies së mendimit të specializuar juridik aparatit të DPSHTRR, në lidhje me hartimin e projekt-akteve ligjore, nënligjore e administrative, në interpretimin e akteve ligjore që rregullojnë veprimtarinë e institucionit për palët e interesuara.
- ❖ bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me strukturat e tjera të institucionit për çështje dhe problematika që dalin në ushtrim të detyrave funksionale.
- ❖ sigurimit në vazhdimësi dhe sistemimin me qëllim azhornimin të të gjitha akteve ligjore e nënligjore në lidhje me veprimtarinë e institucionit.
- ❖ ndjekjes së marrëdhënieve zyrtare në emër të institucionit me organet e drejtësisë dhe prokurorisë për çështje të ndryshme.

Edhe pse mbulon një gamë të gjerë problemesh të ndryshme, ky sektor ka ndjekur me korrektesë problemet dhe detyrat e tij funksionale.

Megjithatë jemi të mendimit se vend për përmirësime ka kudo dhe kurdoherë . Ne jemi të vetëdijshëm se me një angazhim më të madh do të arrijmë që të eliminojmë çdo pasaktësi në punën tonë.

### **3. SEKTORI I PROKURIMEVE.**

Sektori i Prokurimeve në varesi të Drejtorisë së Administratës dhe Shërbimeve Mbeshtetëse ka filluar të funksionojë si Sektor i ndare nga Sektori Juridik pas ndryshimit të Struktura të miratuar nga Ministri i MPPIT-se dërguar me shkresën nr 641/1, date 9.02.2009 dhe në vijim me strukturën e re miratuar me shkresë nr 2469/1 date 25.06.2014



Sektori i Prokurimeve ka si detyrë funksionale zbatimin me korrektesi të Ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" me të gjitha ndryshimet përkatëse, të VKM-se nr.914 dt.29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, në zbatim të ligjit të sipërpërmendur. Në zbatim të VKM-se nr.914 dt.29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me të gjitha ndryshimet përkatëse, neni 4 dhe 7, Autoriteti Kontraktor është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e:

- Regjistrin e Realizimit të Prokurimeve Publike çdo 4 muaj,
- Regjistrin e Realizimit Vjetor ,
- Per fondet e krijuara apo të shtuara hartohet Regjister Shtese .
- Regjistrin Vjetor të Parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën që parashikohet në Udhëzimet e APP-se.

Për plotësimin e këtij detyrimi ligjor nga Autoriteti Kontraktor janë dërguar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik brenda afateve ligjore :

- Regjistri i Realizimit vjetor të vitit 2015 (me shkresën nr.1163 prot, datë 19.01.2016 dërguar pranë APP-së dhe për dijeni MTI-se).
- Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike të vitit 2015 (me shkresën nr .1987 prot, datë 11.02.2015 dërguar pranë APP-së , Ministrisë së Financave dhe MTI-se)
- Regjistri i Realizimit për çdo 4- muaj të vitit 2015.
- Për fondet shtese është hartuar regjister shtese i cili është dërguar së bashku me Regjistrat e Realizimit të Prokurimeve.

Të gjitha prokurimet e planifikuara janë realizuar me fondet e brendshme të DPSHTRR-se.

Nga Buxheti i Shtetit për vitin 2015 nuk ka qenë planifikuar asnjë fond buxhetor për DPSHTRR-ne.

Meqenëse nuk është parashikuar asnjë fond buxhetor për DPSHTRR-ne , të gjitha procedurat e prokurimit të cilat kanë filluar në vitin paraardhës(2014) apo që nuk janë realizuar në vitin 2014 kanë vazhduar dhe janë realizuar në vitin pasardhës (2015).

Autoriteti Kontraktor për fondet e krijuara apo të shtuara, harton regjistrat shtese .

Shkaku i hartimit të regjistrit shtese është:

1. Emergjencia që mund të krijohet gjatë vitit .
- 2.Mosparashikimi në varesi të objektit të prokurimit pasi nuk mund të parashikohet sa mall (p.sh. targa, patenta, shtypshkrime) është e nevojshme të prokurohen pasi:

- nuk mund të parashikohet numri i automjeteve të reja që do të targohen si dhe
- nuk mund të parashikohet numri i aplikanteve që konkurojnë për paisjen me leje drejtimi të mjetit.

Analiza vjetore për vitin 2015



- Parashikimi për mallin (shtypshkrime) nuk mund të bëhet pasi në këtë rast kihet parasysh që malli gjendje del jashtë përdorimit (pulla e fundit përdoret në 31 Dhjetor të vitit 2015). Të gjitha pullat e tjera që nuk janë përdorur deri në këtë datë dalin jashtë përdorimit.

Planifikimi për këto mallra bëhet pas 6 (gjashtë) muajve të parë.

Një problem i vazhdueshëm, lidhur me hartimin e Regjistrit të Parashikimit apo të Realizimit të Prokurimeve nga disa Drejtori Rajonale, është mos zbatimi brenda afateve mbi paraqitjen e Regjistrit pranë DPSHTRR-se si dhe mosparaqitja e sakte e të dhënave mbi vlerat e përcaktuara nëse është përfshirë ose jo TVSH-ja. Lidhur me këtë pikë iu është kërkuar Drejtorive Rajonale të vihet në dispozicion në formë elektronike regjistri me qëllim dërgimin në APP brenda afateve ligjore.

Megjithatë problematiken që kemi hasur në plotësimin e Regjistrit të Realizimit për Drejtoritë Rajonale, regjister i cili dërgohet pranë APP-se, e rëndësishme është që është

zbatuar afati ligjor mbi dërgimin e Regjistrit të Parashikimit dhe të Realizimeve në afat pranë Institucionit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Informacion i detajuar mbi Regjistrin e Prokurimeve që dërgohet pranë Institucionit të Agjencisë së Prokurimit Publik jepet si më poshtë :

Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike për vitin 2015 pranë Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Financave. Regjistri i Parashikimit është dërguar me shkresën nr.1987 prot, datë 11.02.2015 pas miratimit të programit ekonomik nga MTI me shkresën nr.747 prot, datë 02.02.2015. Të gjitha prokurimet e planifikuara janë parashikur që të realizohen me fondet e brendshme të DPSHTRR-se.

Me shkresën nr.7324 prot, datë 19.05.2015 është dërguar Regjistri i realizimit të Prokurimeve Publike për 4 muajin e parë të vitit 2015 pranë Agjencisë së Prokurimit Publik.

Me shkresën nr.12237 prot, datë 17.09.2015 është dërguar Regjistri i Realizimit të Prokurimeve Publike për 4 muajin e dytë të vitit 2015 pranë Agjencisë së Prokurimit Publik.

Me shkresën nr.1163 prot, datë 19.01.2016 është dërguar Regjistri i Realizimit të Prokurimeve Publike për 4 muajin e tretë të vitit 2015 si dhe atë vjetor 2015, pranë Agjencisë së Prokurimit Publik si dhe i është dërguar për dënim MTI-se.

Gjatë periudhës 1-vjeçare të vitit 2015 janë hapur gjithsej 22 (njëzetë e dy) procedura prokurimi: Të gjitha procedurat e prokurimit që janë hapur për periudhën 1- vjeçare, janë prokurime elektronike në zbatim të VKM-së nr 45, datë 21.01.2009 "Për kryerjen e



procedurave të Prokurimit Publik në mënyrë elektronike”, përjashtuar këtu procedurat e prokurimit të formës “Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit”, të cilat në zbatim të LPP-se, VKM-se si dhe Udhezimeve të APP-se janë zhvilluar në formë shkresore .

Nga keto prokurime që janë hapur theksojmë që :

- 17 (shtatëmbëdhjetë) procedura janë Realizuar.
- 5 (pesë) procedura janë Anulluar

Nga procedurat e Realizuara :

- 13 (trembëdhjetë) procedura janë të formës “Prokurim i hapur ,
- 1 (një) procedure është procedure e forms “kerkese për propozim ” dhe
- 3(tre)procedura janë të formës “Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit”.

Nga procedurat e Anulluara :

- 5 (pesë) procedura janë të formës “Prokurim i hapur”,

Etapat kryesore që duhet të plotësohen për fillimin e një procedure prokurimi janë:

1. *Hartimi i specifikimeve teknike* . Në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluar nga AK , hartimi i specifikimeve teknike është bërë nga Grupi i punës i ngritur me Urdhër të Titullarit të AK në varesi të objektit të prokurimit.

Lidhur me specifikimet teknike në përgjithësi janë hartuar në përputhje me nenin 23 të LPP-se si dhe akteve ligjore në zbatim . Megjithatë ka pasur raste që si rezultat i kërkesave për sqarim të paraqitura nga Operatorët Ekonomike apo dhe me inisiativën e vet Autoritetit Kontraktor janë bërë modifikime në specifikimet teknike në varesi të objektit të prokurimit . Si rezultat është shtyrë dhe data e tenderit në zbatim të LPP-se.

2. *Llogaritja e vlerës së Kontrates*

Vlera limit e Kontrates publike është shuma totale e pagueshme , pa tvsh e llogaritur nga Autoriteti Kontraktor përpara dergimit për botim të njoftimit të Prokurimit.

Në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor DPSHTRR në përlllogaritjen e vlerës limit të Kontrates janë zbatuar të gjitha procedurat ligjore. Argumentimi i vlerës limit të kontrates është bërë në varesi të objektit të prokurimit si dhe në varesi të specifikimeve teknike.

Përsa i përket argumentimit të fondit limit të prokurimit nëpërmjet testimit të tregut është një nga menyrat që kërkon kohë të mjaftueshme por është një mënyrë që argumenton saktë fondin limit duke pasqyruar ndryshimet e çmimeve në treg të objektit të prokurimit.



Gjate zhvillimit të këtyre procedurave të prokurimit janë hasur dhe probleme të ndryshme .

#### 1. PER PROCEDURAT E REALIZUARA.

##### Problemet :

1. Para datës së hapjes së ofertave janë paraqitur kërkesa për sqarim apo ankesa lidhur me specifikimet teknike. Si rezultat i modifikimeve procedura e prokurimit në zbatim të LPP-se është shtyrë me 5 (pese) dite.
2. Pas përfundimit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura janë paraqitur ankesa nga Operatorët Ekonomikë. Ankesa janë paraqitur pranë AK, si dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

-Pas shqyrtimit të ankesave nga institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, është kthyer për riveditim procedura e Prokurimit apo në shumicën e rasteve është lejuar Autoriteti Kontraktor për vazhdimin e procedurës së prokurimit .Pas Rivedimit të procedurës është dërguar informacioni mbi Rivedimin e procedurës pranë KPP-se.

Përfundimi: AK është lejuar për vazhdimin e procedurës së prokurimit .

3. Pas përfundimit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave u paraqit ankese nga Operatori Ekonomik i s'kualifikuar. Ankesa u paraqit pranë AK. Pas shqyrtimit të ankesës nga AK pas respektimit të afatit nëse do të paraqitej ankese nga ky Operator Ekonomik pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezultoi që nga Operatori Ekonomik nuk u paraqit ankese pranë KPP-se.

Përfundimi Operatori Ekonomik është bindur me përgjigjen që i është dhënë Ankesës së tij nga AK.

#### 4. *Rast tjetër problem i hasur .*

Paraqitja e ankesave jashtë afatit ligjor nga Operatorët Ekonomikë. Përgjigja iu është kthyer në zbatim të plotë të LPP-se .

##### Konkluzioni për Procedurat e Realizura .

1. Pas shqyrtimit të ankesave të ndryshme të paraqitura nga Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit përfundimisht në të gjitha rastet është lënë në fuqi Vendimi i KVO-se dhe AK është lejuar të vazhdojë procedurën e prokurimit.
2. Për procedurat e formës "Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit "Përsa i përket procedurave të kryera nga AK janë procedura që janë kryer në rast emergjent dhe shkak është argumentuar nga Autoriteti Kontraktor. Për këtë lloj procedure është mirë që të mos arrihet pasi në zbatim të LPP-se procedura me e preferuar e prokurimit është procedura e hapur .

##### Per Prokurimet e Anulluara

Shkaqet e anulimit janë:



1. Mosplotesimi i kërkesave të vendosura në DT nga Operatorët Ekonomikë.
2. Mungesë konkurrence
3. Ndryshim i Fondit limit si rezultat i ndryshimit të specifikimeve teknike.

Pas anulimit të prokurimit janë analizuar dhe shkaqet që kanë çuar në anulimin e procedurës së prokurimit bazuar në VKM nr. 914 datë 29.12.2014 për "Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Garantojmë se do të jemi zbatues me korrektesi të Ligjit të Prokurimit Publik dhe Akteve të tjera ligjore e nenligjore, në fuqi, në zbatim të tij.

#### **4. SEKTORI I INFORMACIONIT,**

Një nga prioritetet e institucionit tonë është detyrimi ligjor që ka Sektori i Informacionit, për të informuar qytetarët mbështetur në Ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit".

Ky sektor, në objektin e punës së TIJ, ka informimin në çdo kohë dhe në çdo periudhë të publikut, me informacionet që prodhohen dhe mbahen nga institucioni jonë, duke nxitur kështu integritetin dhe duke garantuar transparencë dhe përgjegjshmëri.

Ndjekja permanente e kërkesave dhe ankesave të përditshme është detyrim i sektorit të Informacionit.

Burimet e informacionit që janë vënë në shërbim të qytetarëve janë:

1. Posta elektronike, ku e-maili [dpshttr@dpshttr.gov.al](mailto:dpshttr@dpshttr.gov.al) është i afishuar në faqen tonë zyrtare [dpshttr.gov.al](http://dpshttr.gov.al). Të gjitha kërkesat apo ankesat e ndryshme, kalojnë në Drejtoritë përkatëse për të dhënë një përgjigje kompetente.
2. Numri Jeshil 0800 85 85, është i afishur në të gjitha ambientet e Drejtorive Rajonale nëpërmjet posterave dhe në faqen e web-it dhe menaxhohet me përgjegjshmëri në shërbim të qytetarëve nga Sektori i Informacionit.
3. Numri Mobile, 068 8015 833, i cili gjithashtu është i afishuar në faqen tonë zyrtare në internet dhe në Drejtoritë Rajonale për t'ju ardhur sa më pranë qytetarëve në rast ankesash.

Sektori i Informacionit ka krijuar një regjister të posaçëm, në të cilin pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim, ankesat dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjister përmban emrin e qytetarit, burimin nga vjen informacioni së bashku me të dhënat përkatëse, përshkrimin e informacionit apo të ankesës dhe përgjigjen e dhënë nga ana jonë. Më pas bëhet një analizë nga sektori ynë për të përcaktuar llojin e problemit, shkaku dhe zgjidhjen sa më të shpejtë, në mënyrë që të standartizojmë punën e të gjithë Drejtorisë dhe Drejtorive Rajonale, të minimizojmë problematikat që lidhen me mos zbatimin e



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR



rregullave dhe të eliminojmë drejt zerimit korrupsionin, duke rritur transparencën, përkushtimin dhe profesionalizmin në punë dhe duke respektuar rregulloret dhe kodin e etikës.

Problematikat apo paqartësitë më të zakonshme shfaqen në:

- Në drejtim të konvertimit të patentave shqiptare dhe italiane, për sa i përket dokumentacioneve dhe procedurave që do t'ju nënshtrohen.
- Verifikimi i lejeve të drejtimit për të gjithë ato mjete që paraqiten me probleme nga shtetet e tjera, në kuadër të transparencës dhe luftës kundër korrupsionit, për të parandaluar rastet, të cilat mund të bëhen pjesë dhe precedent për krim.
- Pyetje të zakonshme bëhen lidhur me rinovimin e lejeve të drejtimit apo në raste humbje/vjedhje.
- Dokumentacioni për leje qarkullimi dhe patenta nderkombetare.
- Apo cdo informacion tjetër të kerkuar.

Komunikimi me shtypin është pjesë e punës së zyre së Informacionit. Informacionet që I janë transmetuar shtypit dhe çfare është kerkuar prej tyre ka pasur të bëjnë me problematikat aktuale, informacionet me të reja (patenta me pike) për tua bërë sa më të lehtë qytetarëve këtë lloj shërbimi. Bashkëpunimi me Drejtoritë brenda DPSHTRR-së për cdo lloj informacioni në shtyp, në faqen tonë të web-it, apo dhe direkt me qytetarët ka qenë shumë efiçent. Kjo ka lehtësuar qytetarët për të marrë shërbimet tona dhe u ka kursyer atyre kohë.

Gjatë vitit 2015 është zhvilluar 1 panair.

Gjatë vitit të ri kalendarik, përkushtimi dhe përgjegjësia do të jetë edhe më e madhe, për të rritur transparencën dhe integritetin e Institucionit tonë, në lidhje me projektet e reja që DPSHTRR do të verë në zbatim, për t'ju ardhur sa më pranë qytetarëve me informacione në interes të tyre.

### 5. SEKTORI I SHËRBIMEVE.

Spektori i Shërbimeve në bazë të detyrave funksionale përcaktuar nga Drejtori i Përgjithshëm, ka menaxhuar me përgjegjësi e në mënyrë korrekte, lëvizjet e makinave të Drejtorisë, ka mbajtur në gadishmëri gjeneratorin për rastet e mungesës së energjisë elektrike, si dhe furnizimin me ujë të vazhdueshëm për nevojat e punonjësve në godinën e Drejtorisë së Përgjithshme...

Por një nga realizimet e dobishme e Sektorit tonë, padyshim është mbajtja në efiçencë e rrjetit elektrik.. Janë përdorur kancelaritë sipas një plan shpërndarje, është respektuar ky plan edhe në shpërndarjen e detergjenteve çdo muaj për pastrimin e ambienteve të



brendshme. Të gjitha këto veprime janë rakorduar me magazinën dhe financën e Drejtorisë së Përgjithshme.

Lidhur me përdorimin e karburantit të makinave, si një çështje problematike ndër vite, mendojmë se Sektori i Shërbimeve edhe gjatë vitit 2015, e mbajti në parametrat e kërkuar. Janë dokumentuar me saktësi dhe rregullisht të gjitha lëvizjet e çdo makine, së bashku me shpenzimet e karburantit, sipas normave të përcaktuara në katalog. Kemi të dokumentuara, gjithashtu, si vitet e mëparshme, të gjitha shërbimet periodike, të domosdoshme për secilën makinë. E njëjta gjë është bërë edhe me gjeneratorët. Karburanti i harxhuar i të cilëve është i dokumentuar në bazë të kilovatorëve të punës. Janë kryer rregullisht shërbime periodike.

*Ne punën tonë jemi munduar të zbatojmë me përpikëri të gjitha detyrat funksionale dhe ligjore. Te pese sektoret janë angazhuar në ndjekjen e detyrave të tyre duke u munduar në mos zvarritjen e punëve. Etika dhe serioziteti në punë është shfaqur në të gjithë punonjësit e sektoreve që mbulohen nga kjo drejtori. Ne jemi të vetëdijshëm se me një angazhim më të madh do të arrijmë që të eliminojmë çdo pasaktësi në punën tonë.*

## **Analiza e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm DPSHTRR**

### **Permbledhje ekzekutive**

Në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 9270 datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" të DRyshuar me Ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010, Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, Urdhërit të Ministrit të Financave nr. 69, datë 29.09.2010 "Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm publik", Urdhërit nr. 89, datë 28.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së njësive publike" po ju paraqesim analizën vjetore të kësaj njësie për vitin 2015.

DPSHTRR funksionon duke u bazuar në VKM nr. 343, datë 21.07.1996 "si institucion shtetëror, person juridik publik me vetëfinancim me statusin e ndërmarrjes shtetërore, kjo e bazuar në ligjin nr. 7582, datë 13.07.1992, "Për ndërmarrjet shtetërore". Kjo Drejtori ofron shërbimin ndaj subjekteve shtetërore dhe private, në veprimtarinë e transportit rrugor, për regjistrimin e mjeteve, për ndërrimin e pronësisë së tyre, pajisjen me targa, pajisjen me leje Drejtimi, për ngritjen dhe informatizimin e regjistrit kombëtar të mjeteve dhe të Drejtuesve të mjeteve, dhënien e licencave e certifikatave, si dhe transferimin e menjëhershëm të të dhënave të kërkuara nga institucionet e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Drejtimit kryesore të misioneve të auditimit për 2015 ishin:

- Zbatimi i rekomandimeve/masave të lëna nga misionet audituese paraardhëse;
- Auditimi mbi performancën dhe vlerësimi i Drejtimit;

Analiza vjetore për vitin 2015



- Zbatimi i akteve ligjore, nen/ligjore e administrative në sektorin e shërbimeve mbështetëse;
- Zbatimi i akteve ligjore, nen/ligjore e administrative në Degën e Financës;
- Zbatimi i akteve ligjore, nen/ligjore e administrative në Aktivitetin e Taksave të Mjeteve;
- Zbatimi i akteve ligjore, nen/ligjore e administrative në Degën e Regjistrimit të Mjeteve dhe Liçensimeve;
- Zbatimi i akteve ligjore, nen/ligjore e administrative në Degën e Lejeve të DRejtlimit;
- Zbatimi i akteve ligjore, nen/ligjore e administrative në sektorin e shërbimit të Kontrollit në Rrugë;

• **Organizimi e Kapacitetet audituese.**

Në përbërjen e kësaj Drejtorie se AB janë planifikuar dhe janë aktualisht në strukturë katër punonjës, DRejtuesi i njësisë dhe tre auditues me arsim të lartë (Fakulteti Ekonomik në UT) dhe të certifikuar me titullin "Audit i brendshëm në sektorin publik". Vjetërsia në këtë profesion varion nga 2 deri në mbi 10 vjet

Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm është e organizuar dhe funksionon si Drejtori më vete, vartësia e të cilit është e drejtpërdrejtë nga Drejtori i Përgjithshëm e kjo e miratuar nga Ministri i MPPIT me shkresën nr. 4836, datë 09.07.2008. Janë ndjekur të gjitha trajnimet e organizuara nga NJQH/MFK në Ministrinë e Financave, ku janë dhënë dhe certifikatat përkatëse, gjithashtu janë planifikuar ditë-trajtime edhe për periudhën e ardhshme 2016.

**I. Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm**

Analiza e programeve dhe misionëve të auditimit për periudhën raportuese. Për vitin ushtrimor 2015 është hartuar programi vjetor i auditimit të brendshëm dhe miratuar nga Titullari i Subjektit me shkresën nr. 15453, datë 14.10.2014. Nga 15 subjekte që ka DPSHTRr-ja, janë planifikuar 9 (nëntë) auditime të plota dhe 1 (një) auditim i pjesshëm me objekt ndjekja e zbatimit të rekomandimeve. Në fakt janë realizuar 6 (gjashtë) auditime të plota dhe 3 (tre) auditime të pjesshme. Në tabelën e mëposhtme po paraqesim planifikimin dhe realizimin e auditimeve të plota/të pjesshme sipas DRejtorive rajonale:

| Nr. | Drejtoria<br>Rajonale | Auditim i Plotë |           | Auditim i Pjesshëm |           |
|-----|-----------------------|-----------------|-----------|--------------------|-----------|
|     |                       | Planifikuar     | Realizuar | Planifikuar        | Realizuar |
| 1.  | DPSHTRr               | 1               | =         | =                  | =         |
| 2.  | Tiranë                | =               | 1         | 1                  | 3         |



|     |                |          |           |          |          |
|-----|----------------|----------|-----------|----------|----------|
| 3.  | Durrës         | 1        | 1         | =        | =        |
| 4.  | Berat          | 1        | 1         | =        | =        |
| 5.  | Kukës          | 1        | 1         | =        | =        |
| 6.  | DTSH           | 1        | =         | =        | =        |
| 7.  | Laç            | 1        | 1         | =        | =        |
| 8.  | Gjirokastër    | 1        | 1         | =        | =        |
| 9.  | Sarandë        | 1        | =         | =        | =        |
| 10. | Dibër          | 1        | =         | =        | =        |
| 11. | Elbasan        | =        | në proces | =        | =        |
|     | <b>Totali:</b> | <b>9</b> | <b>6</b>  | <b>1</b> | <b>3</b> |

Janë evaduar nga Drejtoria e Përgjithshme 6 misione auditimi të plota dhe 3 misione të pjesshme auditimi. Është në proces misioni i auditimit të brendshëm në subjektin DRShTRr Elbasan. Arësytet e mosrealizimit të misioneve të plota të auditimit kanë qenë:

- kryerja jashtë planifikimit e misionit të auditimit në DRShTRr Tiranë, si i vetmi subjekt i planifikuar me risk të lartë.
- kryerja jashtë planifikimit e misionit të auditimit në DRShTRr Elbasan, subjekt i cili renditet i katërti në realizimin e të ardhurave vjetore në shkallë vendi.
- kryerja e 3 misioneve të pjesshme të auditimit në DRShTRr Tiranë, nga 1 mision i planifikuar, si subjekt i planifikuar me risk të lartë.
- DRShTRr Elbasan, Durrës, Gjirokastër, Kukës, Laç të cilat kishte mbi 3 vjet të aktivitetit të tyre pa audituar perkatesisht të viteve 2012- 2013-2014-2015,

Objekte të pa audituara mbi dy vjet për vitin 2015 janë DRShTRr Dibër dhe Sarandë, të cilat do realizohen brenda tremujorit të I-rë 2016.

#### • Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre

Nisur nga faktori "risk", NJAB ka përcaktuar që në fazën e planifikimit fushat me risk të lartë mbi të cilat është bërë dhe plani vjetor i auditimit. Konkretisht është trajtuar si aktivitet me risk të lartë;

- "sektori i taksave vjetore të mjeteve, tarifa e shërbimeve".

- "realizimi i procedurave të prokurimit publik".



- "faturimi dhe arkëtimi i shërbimeve në degën e lejeve të Drejtimit në mënyrë manuale" si dhe
- "efiçensës së shërbimit të kontrollit në rrugë të mjeteve të transportit rrugor". Nga NJAB për të zvogëluar riskun në rastet e mësipërme puna audituese është përqëndruar:
- Në aktivitetin e taksave të mjeteve është audituar mbi arkëtimin e takses si dhe tarifen e shërbimeve të ofrura, detyrimeve debitoare, në moskryerjen e veprimeve në degët dhe sektorët e shërbimit me detyrime të paarkëtuara të taksave, si dhe në njoftimin e subjekteve fizike/juridike për këto detyrime.
- Në prokurimet publike është audituar mbi zbatimin e procedurave ligjore të prokurimit publik. Konkretisht është audituar hartimi i specifikimeve teknike, argumentimi i fondit limit, vlerësimi i ofertave të paraqitura si dhe realizimi i kontratës.
- Në degën e lejeve të Drejtimit faturimi dhe arkëtimi i shërbimeve bëhet në mënyrë manuale. Gjatë procesit të auditimit janë çiflëzuar informacionet kompjuterike të degës së prodhimit të lejeve të Drejtimit me dokumentacionin e arkës, janë audituar në dosjet e aplikantëve arkëtimet e tarifave sipas rastit, paisja me autorizime teori/praktikë, futja në testim dhe ritestim, arkëtimi i tarifës dhe taksës së lejes së Drejtimit sipas kategorisë përkatëse, shërbimi i paisjes me akt-vlerësime teknike për mjetet autoshkollë, etj.
- Aktiviteti i kontrollit në rrugë të mjeteve të transportit rrugor respektimi i procedurave të kontrollit, arkëtimin e gjobave etj. Kontrolli mbi zbatimin e Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodit Rrugor i RSH-së", neni 79, pika 10 "tejkalimi i afatit të kontrollit teknik" bashkëpunimi me strukturave të Ministrisë së Brendshme të Prefekturës;

**• Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe reagimi i menaxhimit.**

Sistemi i kontrollit të brendshëm në DRSHTRr Rajonale ka shënuar përmirësime të ndjeshme krahasuar me vitet paraardhëse. Drejtoret, Shefat e degët e financës së DRSHTRr-ve Përgjegjës të regjistrimit të mjeteve, Përgjegjës të degës së lejeve të Drejtimit si dhe Përgjegjës të kontrollit në rrugë kanë njohje të MFK, por ka akoma shumë vend për përmirësime në nivel specialistesh për një njohje më të mirë të bazës ligjore dhe detyrave, që ka si pasojë një numër të gjatë me mosperputhje të akteve ligjore, nënligjore e administrative, mungesë të gjurmës së auditit, si dhe disa paqartësi në ndarjen e detyrave.

Bazuar në gjetjet, rekomandimet përkatëse të cilat janë përcaktuar në raportet finale të cdo DRSHTRr të audituar gjatë 2015, nga menaxhimi në këto Drejtori është reaguar pozitivisht:

1. Për rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm me qëllim që të sigurohet përdorimi me efektivitet, ekonomi dhe efiçencë të fondëve. Këto rekomandime synojnë në rritjen e cilësisë së planifikimit dhe zbatimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, vendosjen e rregullave të kujdesshme për parandalimin e mashtrimit dhe vjedhjes, ruajtjen e aseteve etj;

2. Për rekomandime për përmirësimin e proceseve të implementimit të politikave, kuadrin ligjor e procedural të brendshëm e të jashtëm që drejton veprimtarinë e DRSHTRr-ve sic janë rregulloret e brendshme të DRSHTRr. Këto rekomandime synojnë në vendosjen e procedurave dhe rregullave të qarta për parandalimin e fenomeneve negative, verifikimeve,



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR



autorizimeve, ndarjen e detyrave sipas funksioneve dhe roleve të çdo (nëpunësi) zyrtari. Keto rekomandime kërkojnë një kohë relativisht të gjatë për realizimin komplet të tyre.

3. Për rekomandime për trajnimin profesional të punonjësve dhe sidomos stafit që punon në strukturat e menaxhimit financiar.

4-Për rekomandimet që kanë të bëjnë me përputhshmërinë e zbatimit të bazës ligjore në fuqi të funksionimit të aktivitetit të DRSHTRR të e DPSHTRR-se, janë analizuar dhe marrë në konsideratë nga Menaxhimi në DRSHTRR, janë marrë masa të menjëhershme për përmirësimin e tyre pasi dhe natyra e zbatueshmërisë së këtyre rekomandimeve është gati e menjëhershme, masa parandaluese administrative për punonjësit, si programe të trajnimeve të vazhdueshme si në DPSHTRR dhe në DRSHTRR, njohjen me në thellësi e zbatim të sistemeve të kontrollit të brendshëm e vlerësimit sa me objektiv të treguesve të performances për secilin punonjës. Jane përgatitur memorandumet për të gjitha misionet e auditimit që me miratimin nga Drejtoria i Përgjithshëm i DPSHTRR do të ndiqen e raportohen nga DAB në vazhdimësi.

### II. Konkluzione

Auditimi i brendshëm i DPSHTRR mbështet menaxhimin duke dhënë siguri që sistemet e kontrollit të brendshëm janë ngritur në pajtueshmëri me rregullat dhe standartet dhe sipas parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Konkluzionet kryesore duke u nisur nga gjetjet dhe rekomandimet së veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin 2015 janë:

-Njohja dhe zbatimi i parimeve të MFK në Drejtorite Rajonale (DRSHTRR) ka rritje nga viti në vit, sidomos veprimtaria në vitin 2015, megjithatë ka vend për përmirësime të mëtejshme me qëllim arritjen e rezultateve sa më pozitive në realizimin e veprimtarisë në përputhshmëri sa me të plotë ligjore dhe të cilësive të shërbimit. Hartimi i një rregullorje të brendshme të perditësura dhe një trajnim e testim i punonjësve në keto Drejtoria do të ndihmonë në një njohje dhe zbatueshmëri me të plotë të ligjeve dhe akteve nënligjore.

-Kryerja rregjistrimeve kontabile të veprimeve dhe ngjarjeve ekonomike mbi bazën e dokumentave justifikuese si dhe shfrytëzimi i perparësive të sistemit të kontabilizimit informatik ALFA nuk është neperputhje të plotë me standartet e kontabilitetit, prandaj kërkohej trajnim e testim i punonjësve të degeve të Finances etj në këto drejtim.

-Ushtrimi i kontrollit mbi realizimin e objektivave e zbatimin e procedurave operacionale në çdo hallkë të shërbimeve, si dhe dokumentimi dhe marrja e masave administrative parandaluese pas analizimit të rezultateve të kontrollit nga Drejtoret e DRSHTRR dhe Përgjegjësit e degeve, Finance, Rregjistrim Mjetit, Leje Drejtimit, Kontrollit në rrugë etj kërkohej të jete në mënyrë sistematike, periodike mujore.

-Jane realizuar objektivat: *ne fushen e të ardhurave*, deri dhe me tejkalime në krahasim me planin dhe faktin e viteve të mëparshme; *ne fushen e shpenzimeve*, nuk janë tejkaluar shpenzimet krahasuar me planin dhe faktin e viteve të mëparshme në shumicën e DRSHTRR të audituara, është shënuar një rritje në numrin e shërbimeve dhe ka pasur gjithashtu rritje të nivelit të cilësive (pakesim të kohës së përfundimit të shërbimeve) së këtyre shërbimeve, faktori kryesor është informatizimi i tyre (sic është rasti formularit të aplikimit online) megjithatë ka vend akoma për përmirësime të vazhdueshme të cilësive së



ofrimin te sherbimeve te DRSHTRR Rajonale ne nje kohe sa me te shkurter duke eliminuar keqinterpretimet dhe dukomentacionin e tepert burokratik .

- **Prioritetet për vitin e ardhshëm**

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2016 D/AB do të fokusohet në:

- Në Drejtim të performancës dhe kontributit në shtimin e vlerës dhe këshillave për menaxhimin, kanë qenë dhe mbeten në fokus kryesor ato aktivitete apo fusha me risk të lartë në shtimin e vlerës, apo në zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar dhe të Drejtimit.
- Prioritet do të jetë rishikimi dhe zhvillimi i praktikave ose procedurave, të cilat sjellin efekt, japin siguri dhe maksimizojnë vlerën e njësisë që auditojmë, si dhe vlerën e shërbimit të auditimit të brendshëm, në veçanti përmirësimin e cilësisë së rekomandimeve.
- Realizimin e planit të misioneve të AB për vitin 2016.
- Ndjekjen dhe zbatimin e të gjitha rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2015 në bashkëpunim me Drejtimin dhe menaxhimin.
- Ndjekjen e trajnimeve profesionale nga të gjithë audited e D/AB që do të organizohen nga NJQH/MFK.

### **Drejtorja e Kontrollit të Mjeteve dhe Sigurisë Rrugore**

Drejtorja e Kontrollit të Mjeteve dhe Sigurisë Rrugore pranë Drejtorisë të Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor është Drejtori Operative dhe përbëhet nga Drejtorja në qendër dhe 13-sektorët , pranë Drejtorive Rajonale.

#### Drejtorja e Kontrollit të Mjeteve dhe Sigurisë Rrugore ka si detyrë:

- Kontrollin dhe monitorimin e shfrytëzimit ekonomik të automjeteve që operojnë në fushën e transportit të udhëtarëve dhe mallrave.
- Mbrojtjen e interesit publik dhe të interësve të ligjshme të personave fizikë e juridikë.

Ajo vepron mbështetur në Ligjin nr.8378,datë 22/07/1998 "Kodi Rrugor" i Republikës së Shqipërisë , i ndryshuar; Ligjin nr.8308,datë 18/03/1998,"Ligji për Transportet Rrugore në Republikën e Shqipërisë", dhe akte të tjera ligjore e n/ligjore që rregullojnë aktivitetin në fushën e transportit të udhëtarëve dhe mallrave në Republikën e Shqipërisë.

#### Qëllimin dhe detyrën ky shërbim e kryen nëpërmjet:

- a – Vlerësimit të respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i kontrolluar,
- b – Këshillimit të subjektit të kontrolluar për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore,
- c – Urdhërimit të korigjimit të shkeljeve të kërkesave ligjore dhe eliminimit të pasojave që rrjedhin prej tyre,



d – Dhënies së dënimeve dhe marjes së masave të tjera administrative për shmangien e rreziqeve që mund tu shkaktohen interesit publik dhe interesit të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë , të parashikuar nga Udhëzimet apo legjislacioni i posaçëm. Gjatë punës së saj , Drejtoria e Kontrollit të Mjeteve dhe Sigurisë Rrugore nuk ka pasur asnjëherë si qëllim në vetvehte masën administrative , por, nëpërmjet saj edukimin dhe disiplinimin e transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve.

Drejtoria e Kontrollit të Mjeteve dhe Sigurisë Rrugore në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorin e tjerë në DPSHTRr , e ka përqëndruar punën e saj në këto drejtime kryesore:

- 1-Në përgatitjen dhe kualifikimin e kandidatëve për inspektor të kontrollit rrugor.
- 2-Në zbatimin me rreptësi dhe përpikmëri të legjislacionit të transportit rrugor.
- 3-Në mënyrën e mbajtjes dhe plotësimit të dokumentacionit që pasqyron veprimtarinë e shërbimit.
- 4-Në paisjen e sektorëve me sinjalistike rrugore , në zbatim të urdhërave dhe udhëzimeve për sigurinë rrugore si dhe me dokumentacionin e nevojshëm e të unifikuar që duhet të kenë sektorët e kontrollit në rrugë.
- 5-Në paisjen e sektorëve me mjete motorike.
- 6-Në shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të qytetarëve.

Kjo drejtori , ndër të tjera, jemi përqëndruar tek zbatimi i orarit të shërbimit, mënyra e komunikimit me transportuesin, qëndrimi në rrugë, plotësimi korekte i proces-verbaleve, plotësimi i dokumentacionit të p/sectorit, zbatimi i ligjit nr.8308, datë 18/03/1998."Për transportet rrugore"i ndryshuar, ligjit nr.8378, datë 22/07/1998, "Kodi Rrugor"i ndryshuar, dhe për zbatimin e masave për sigurinë rrugore.

Drejtoria e Kontrollit të Mjeteve dhe Sigurisë Rrugore, rëndësi të veçantë i ka dhënë kontrollit të transportit të udhëtarëve dhe mallrave, peshave mbi aks, certifikatën e kontrollit teknik e detyrimeve të qytetarëve për taksat e mjeteve në qarkullim, Tahografit, mënyrën e operimit të Taksive.

Kjo drejtori ka luftuar për kontrollin dhe vënien në zbatim të legjislacionit në fushën e transportit qytetës , rrethqytetës dhe ndërqytetës për eliminimin e konkurrencës së pandershme, por në këtë drejtim ka shumë punë për të bërë.

Duke parë fluksin e madh të mjeteve të tonazhit të rëndë dhe me ngarkesa jashtë normës së lejuar , mbrojtjen e rrjetit rrugor nga dëmtimet , kjo drejtori nëpërmjet peshoreve elektronike monitoron një pjesë të mirë të këtyre mjeteve.

Per vitin 2016 puna jonë do të fokusohet në:

1. Kontrolli për ÇAP-in.
2. Kontrolli për certifikatën ADR të mjetit.
3. Kontrolli në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave.



Si rezultat i punës tonë duke qënë këmbengulës gjatë vitit 2014 dhe 2015, që transportuesit të pajisen me dokumentacionin përkatës dhe të operojnë sipas rregullave në fuqi, në vitin 2015 po të bëjmë një krahasim të gabave të vendosura me vitin 2014 ka një rënie të shkeljeve të konstatuara me 1000 gjoba më pak.

Për gjatë vitit 2015 për mjetet që kanë qënë përsëritës në shkeljet e tyre masa e gjobës ka qënë më e lartë, po takrahasojmë me 2014 pavarësisht se në 2015 janë vendosur 1000 gjoba më pak shuma e lekëve ka qënë rreth 6 milion më lartë.

Për të folur më shifra më konkrete si për secilën drejtori dhe si dhe për disa shkelje që konsiderohen më të rëndësishme, më posht gjendet tabela për penalitetet e vendosura për vitin 2015 dhe tabela e krahasimeve me vitin 2014.

**Evidenca dhe krahasimet per shkeljet e konstatuara, vetem per mjetet e regjistruara ne Shqiperi, gjate vitit 2014-2015**

| NR                | Drejtoria<br>rajonale | Mjete te penalizuara |               |                   |                   | Transport udhetaresh brenda vendit |              |              |              | Per shkelje te ndryshme |              | Per shkelje te ndryshme ne transportin e mallrave brenda vendit |              |
|-------------------|-----------------------|----------------------|---------------|-------------------|-------------------|------------------------------------|--------------|--------------|--------------|-------------------------|--------------|-----------------------------------------------------------------|--------------|
|                   |                       | gjoha                |               | vlere             | vlere             | me autobuz                         | me autobuz   | me taksi     | me taksi     | autovetura              |              | gjoha                                                           |              |
|                   |                       | 2014                 | 2015          | 2014              | 2015              | gjoha                              | gjoha        | gjoha        | gjoha        | 2014                    | 2015         | 2014                                                            | 2015         |
|                   |                       |                      |               |                   |                   |                                    |              |              |              |                         |              |                                                                 |              |
| 1                 | Tiranë                | 3,121                | 1,684         | 8,888,000         | 9,222,000         | 444                                | 243          | 341          | 138          | 474                     | 284          | 1,862                                                           | 969          |
| 2                 | Durrës                | 2,523                | 1,446         | 7,211,000         | 6,103,000         | 513                                | 375          | 354          | 129          | 134                     | 183          | 1,522                                                           | 758          |
| 3                 | Laç                   | 1,596                | 1,721         | 3,995,000         | 4,558,000         | 379                                | 383          | 119          | 114          | 83                      | 193          | 1,015                                                           | 1,030        |
| 4                 | Elbasan               | 1,177                | 1,765         | 2,238,000         | 3,663,000         | 325                                | 390          | 177          | 140          | 204                     | 342          | 471                                                             | 894          |
| 5                 | Fier                  | 1,141                | 1,115         | 5,062,000         | 6,293,000         | 73                                 | 113          | 100          | 102          | 50                      | 67           | 919                                                             | 833          |
| 6                 | Korçë                 | 805                  | 1,230         | 2,200,000         | 2,966,000         | 71                                 | 162          | 140          | 194          | 329                     | 375          | 265                                                             | 499          |
| 7                 | Berat                 | 544                  | 538           | 842,000           | 1,891,000         | 90                                 | 108          | 36           | 55           | 82                      | 90           | 336                                                             | 285          |
| 8                 | Shkodër               | 433                  | 431           | 1,184,000         | 1,066,000         | 153                                | 106          | 41           | 29           | 164                     | 189          | 73                                                              | 107          |
| 9                 | Kukës                 | 335                  | 276           | 475,000           | 612,000           | 50                                 | 57           | 12           | 21           | 44                      | 40           | 229                                                             | 158          |
| 10                | Sarandë               | 253                  | 294           | 1,240,000         | 1,475,000         | 38                                 | 39           | 11           | 34           | 57                      | 71           | 147                                                             | 150          |
| 11                | Vlorë                 | 224                  | 598           | 747,000           | 2,137,000         | 20                                 | 80           | 31           | 85           | 55                      | 136          | 118                                                             | 297          |
| 12                | Gjirokastrë           | 178                  | 279           | 403,000           | 671,000           | 31                                 | 36           | 20           | 41           | 35                      | 50           | 92                                                              | 152          |
| 13                | Dibër                 | 158                  | 110           | 207,000           | 172,000           | 24                                 | 15           | 5            | 3            | 101                     | 82           | 28                                                              | 10           |
| <b>Shuma</b>      |                       | <b>12,488</b>        | <b>11,487</b> | <b>34,692,000</b> | <b>40,829,000</b> | <b>2,211</b>                       | <b>2,107</b> | <b>1,387</b> | <b>1,135</b> | <b>1,812</b>            | <b>2,102</b> | <b>7,077</b>                                                    | <b>6,142</b> |
| <b>Dy vjecari</b> |                       | <b>23,975</b>        |               | <b>75,500,000</b> |                   | <b>4,318</b>                       |              | <b>2,522</b> |              | <b>3,914</b>            |              | <b>13,219</b>                                                   |              |

**Shenim:** Shuma e parashikuar per tu vjelur **87,200,000** lek.

Shuma totale e vjelur **82,100,000** lek.

Shuma per tu vjelur **5.100.000** lek.

Shuma eshte me e larte per shkak te kamat vonesave.